



Kastriot Sada

# Art muzikor

Libri i mësimdhënësit/es

Për klasën e tetë të arsimit të mesëm të ulët

# 8



# PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes.....	5
Hyrje.....	7
Planifikimi vjetor.....	15
Plani dymujor: shtator—tetor.....	16
Plani dymujor: nëntor—dhjetor.....	20
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	24
Plani tremujor: prill—maj—qershor.....	28
Mësimi 1: Fuqia e muzikës.....	32
Mësimi 2 : Këndojmë në kor.....	34
Mësimi 3: Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë.....	36
Mësimi 4: Shenjat e përsëritjes.....	38
Mësimi 5: Shenjat e shprehjes.....	40
Mësimi 6: Shenjat e shartimit.....	42
Mësimi 7: Mora fjalë.....	44
Mësimi 8: Ritmi i përzier 5/8.....	46
Mësimi 9: Kur hyna n’portë t’kalasë.....	48
Mësimi 10: Elementet muzikore.....	50
Mësimi 11: Kantata dhe oratorioja.....	52
Mësimi 12: Simfonia dhe analiza e saj.....	54
Mësimi 13: Ritmi i përzier 7/8.....	56
Mësimi 14: Kur këndoj për ty moj nënë.....	58
Mësimi 15: Shkalla F-dur.....	60
Mësimi 16: Frymëzohemi nga artet e tjera.....	62
Mësimi 17: Njohim disa instrumente muzikore.....	64
Mësimi 18: Interpretues të shquar.....	66
Mësimi 19: Vallet tona popullore.....	68
Mësimi 20: Kur bien fyelli, çiftelia.....	70
Mësimi 21: Ritmi i përzier 9/8.....	72
Mësimi 22: Kur filloi drita me dalë.....	74
Mësimi 23: Shkalla D-Mol.....	76
Mësimi 24: Luajmë në instrument.....	78
Mësimi 25: Muzika dhe loja.....	80
Mësimi 26: Luleborë.....	82
Mësimi 27: Njohim kompozitorët tanë.....	84
Mësimi 28: Muzika zbavitëse (e lehtë).....	86
Mësimi 29: Eja në Prishtinë.....	88
Mësimi 30: Muzika xhaz.....	90
Mësimi 31: Muzika rok.....	92
Mësimi 32: Blowing in the Wind.....	94
Mësimi 33: Videoklipi muzikor.....	96
Mësimi 34: Krijojmë një këngë.....	98
Mësimi 35: Muzika e filmit.....	100

Të dashur mësuese dhe mësues,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë në zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara të sotme.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar përmes vështirësive të panumërta dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për të formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për të gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, Shtëpia Botuese "Dukagjini" në vazhdim të nismës për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: *Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për formësuar të ardhmen e tyre?*

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe nxënies, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues, bashkëpunues dhe kurioz, i aftë për të përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme dhe të nesërme shqiptare.

Cilësia e re e të nxëniet dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por kërkohet të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për të motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.


Modeli i këtyre librave është i pranishëm për herë të parë në Kosovë i zbatuar në vitin 2022 dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

# UDHËRRËFYES

## për konceptimin e mësimëve model

### Faqja në të majtë

- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Mësimi synon që përmes rezultateve të të nxënës të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.
- Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënës.
- Parashikimi, faza e parë e orës mësimore, e cila siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.
- Rezultatet e të nxënës të temës janë në koherencë me ato të orës mësimore, tema është më e gjerë.
- Rezultatet specifike të të nxënës janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zërthim i rezultateve të të nxënës sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënës të klasës.
- Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera që evidencohen.

### Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit, ndihmon mësuesin/en, gjatë përgatitjes.
- Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënës.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.



- Përpunimi i përmbajtjes, faza e dytë e orës mësimore, e cila bën përzgjedhjen e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik të tij.
- Përforsimi, faza e tretë e orës mësimore, e cila bën integrimin e dijeve dhe të shprehive dhe zbatimin e tyre.

## Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimi

Rezultatet e të nxënës të temës janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënës për këtë temë. Në këtë rast, mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënës të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënës dhe nga elementet përbërëse të tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës.** Duke filluar nga klasa e tretë e më lart, nxënësit zotërojnë operacione mendore; të menduarit e tyre është konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Prandaj, mësimi me këta nxënës kalon në tri faza, dhe të menduarit e tyre sipas proceseve njohëse.

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës.** Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

**Rezultatet e të nxënësve.** Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimi, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës që janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

**Kriteret e vlerësimit/suksesit** janë zërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - fazat** e zhvillimit të mësimi. Tashmë nxënësit, duke filluar nga klasa e tretë e lart, zotërojnë operacionet mendore, të cilat kanë karakter konkret, me elemente të të menduarit abstrakt. Me kalimin në klasat më të larta, marrin karakter mbizotërues, pasi të menduarit është formal. Mësimi me këta nxënës kalon në tri faza të të menduarit gjatë të nxënësve, sipas proceseve njohëse.

### *Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimi?*

Mbillet një farë. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësimdhënësi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të vazhduar më tej.



#### **Parashikimi: Përgatitja për të nxënës**

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të të nxënësve. Në këtë fazë kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimi, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



#### **Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes**

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive. Gjithashtu, ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



#### **Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve**

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësve të ri dhe ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

# Hyrje

## Konceptimi dhe ndërtimi i librit të mësuesit

### ART MUZIKOR 8

Artet (muzika, artet pamore, vallëzimi, drama) janë pjesë e kulturës dhe shërbejnë si mjet universal komunikimi e interpretimi të ideve e mesazheve dhe emocioneve individuale e kolektive. Artet përfshijnë krijimtarinë artistike autoriale, por edhe elemente të trashëgimisë kulturore lokale, kombëtare e universale të manifestuar përmes kulturës, artefakteve, objekteve dhe krijimtarisë popullore (këngët, vallet, lojërat, legendat, përrallat, mitet etj.).

Edukimi artistik u mundëson nxënësve të kenë vizion, të planifikojnë dhe të caktojnë qëllime, të përcaktojnë metoda të ndryshme si t'i arrijnë ato qëllime, të identifikojnë alternativat, t'i rishikojnë ato, të zgjidhin probleme, të imagjinojnë, të punojnë në grupe dhe të aplikojnë vetëdisiplinë, durim, përqendrim, guxim dhe iniciativë. Me të gjitha këto veprime në fushën mësimore - *Artet*, nxënësit përdorin tërë potencialin e tyre njerëzor, emocional dhe kreativ në mënyrë unike. Të mësuarit përmes arteve e mundëson një nivel të të menduarit më specifik, më krijues dhe më të avancuar, të bazuar në gjykim, invencion dhe imagjinatë.

Fusha kurrikulare *Artet* në nivelin e dytë përfshin Artin muzikor. Shkolla inkurajohet që edhe në këtë nivel nxënësve t'u ofrohet mundësia që të marrin pjesë edhe në forma të tjera të shprehjes artistike të artit muzikor, siç janë: këndimi koral, orkestra, ansamblet muzikore, rok dhe pop-bendet e shkollës, vallëzimi modern etj.

### Udhëzime metodologjike


Artet edukojnë në mënyrë të suksesshme për arritjen e kompetencave të parapara në kurrikulën e Kosovës, vetëm nëse gjatë mësimdhënies zbatohen në mënyrë të duhur parimet didaktike dhe metodike përkatëse në secilën prej lëndëve mësimore në fushën artet.

Metodologjia e mësimdhënies në lëndët artistike përfshin teknika dhe metoda mësimore specifike për zhvillimin e kompetencave artistike. Në këtë nivel duhet të përdoret kryesisht loja krijuese, intuita, mësimdhënia e integruar, e diferencuar (në bazë të prirjeve dhe interesimeve individuale të nxënësit), si dhe qasja konstruktive e të nxënimit me nxënësin në qendër. Përjetimi artistik, nxitja e kërkshërës, e imagjinatës, liria e të shprehurit dhe inkurajimi i krijimtarisë janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve.

### Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënët

Libri që keni në duar, është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathësive. Ai trajton temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës" (e rishikuar) (2016) si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënimit të fushës, rezultatet specifike të të nxënimit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe dështimet, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvillonin mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndësh magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhëniet koherente midis rezultateve të të nxënit, veprimtaritë e mësimdhënies të të nxënit dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



*Burimi: Nga Metodologji e mësimdhënies, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE*





**Zgjeroni dhe thelloni  
dijet**

*Për më shumë lexoni  
në: Musai. B. (2014)*

*Metodologji e mësimdhënies.  
Tiranë: CDE, faqe 101-128.*

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënësve të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës, sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen



**Zgjeroni dhe thelloni  
dijet**

*Për më shumë lexoni  
në: Woolfolk. A. (2011)*

*Psikologji edukimi. Tiranë: CDE,  
faqe 47-51.*

e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënësia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësimdhënësi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



**Zgjeroni dhe thelloni dijet**

Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

## Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 4

Nr. Rezultatet e të nxënit për shkallën 4 dhe kompetencat kryesore	
<b>I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv</b>	
1.	Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
2.	Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.
5.	Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshtuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.
6.	Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

<b>II Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ</b>	
1.	Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.
2.	Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.
5.	Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi apo të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu.
6.	Demonstron zgjidhjen e një problemi (matematik, lingvistik etj.) bazuar në të dhënat tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale të detyrës e cila bëhet në klasë/shkollë apo jashtë saj, duke arsyetuar me gojë zbatimin e ecurive përkatëse për arritjen e rezultatit.
7.	Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

<b>III Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm</b>	
3.	Regjistron në skeda dhe teknika të tjera të veçanta, TI etj., informatat ose faktet a formulat për një temë të caktuar duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë mësimore të tyre.
5.	Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas këtë para të tjerëve.
6.	Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.
7.	Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

#### IV Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

- |    |  |
|----|--|
| 1. | Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme. |
|----|--|

#### V Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

- |    |   |
|----|---|
| 6. | Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre.  |
| 9. | Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehitë negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo i drogës etj.). |

#### VI Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

- |    |  |
|----|--|
| 1. | Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.). |
| 6. | Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.                                      |

## REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET Shkalla 4, klasa VIII

1. NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË	
<b>1. Krijimtaria dhe performanca artistike</b> Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.	
1.	Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë).
2.	Interpreton në tërësi role (karakterë) të ndryshme.
3.	Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).
4.	Vizaton, ngjyros, modelon peizazh, portret, kompozicione dy e tridimensionale etj., në mënyrë të lirshme ose me temë të caktuar.
5.	Krijon këngë dhe shoqëri instrumentale në zhanre të ndryshme (popullore, artistike, argëtuese).
7.	Krijon dhe kontribuon në realizimin skenik të teksteve për shfaqje të ndryshme (dramë, komedi, muzikë).

2. Gjuha dhe komunikimi artistik	
Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.	
1.	Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike, duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.
4.	Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).

3. Relacioni art-shoqëri	
Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjellas në kontekstin historik, social dhe kulturor.	
1.	Njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror.
2.	Demonstron të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasika, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).
3.	Prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global dhe lokal e kombëtar.

4. Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik	
Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.	
1.	Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikat e përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.
2.	Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë.
3.	Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.

## II. VLERAT DHE QËNDRIMET QË PROMOVOHEN PËRMES ARTEVE

- Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës;
- Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme;
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia;
- Përqendrimi dhe durimi.

## III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË

- Të vërejturit/të dëgjuarit/aftësitë perceptuese;
- Aftësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë (tingullore, e ngjyrave, e formave, e strukturave, e karaktereve, e lëvizjeve etj.);
- Aftësitë përjetuese artistike;
- Vëmendja dhe memorizimi;
- Vullneti dhe motivacioni;
- Iniciativa dhe interesimi;
- Imagjinata dhe kreativiteti;
- Shkathësitë muzikore;
- Shkathësitë lëvizore;
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar;
- Shkathësia për punë ekipore;
- Të menduarit analitik, kritik dhe kreativ.

**Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Artet Klasa VIII**

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	Gjysmëvjetori I		Gjysmëvjetori II		
	Shtator—tetor	Nëntor—dhjetor	Janar—shkurt—mars	Prill—maj—qershor	
Edukatë muzikore	Njoftim i nxënësve me planprogram dhe mjete mësimore	Elementet muzikore	Krijuesit dhe performuesit	Këngë	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv I.1; I.2; I.5; I.6,
	Këngë	Elementet e formave muzikore	Krijuesit dhe performuesit	Këngë	
	Elementet muzikore	Gjinitë (llojet) muzikore	Elementet muzikore	Zhanret muzikore	Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm III.3; III.5; III.6; III.7,
	Shkrim-leximi muzikor	Tonalitetet	Tonalitetet	Kreativitet muzikor	
	Test vlerësues	Ngjarje muzikore	Interpretim në instrumente	Test përmbledhës	Kompetenca personale - Individ i shëndoshë V.6; V.9,
		Instrumentet dhe formacionet muzikore	Ngjarje muzikore		
		Test përmbledhës	Test vlerësues		
	<b>Gjithsej 8 orë</b>	<b>Gjithsej 9 orë</b>	<b>Gjithsej 11 orë</b>	<b>Gjithsej 11 orë</b>	

# PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

## Lënda mësimore: Edukatë Muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: VIII

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.1	Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të shprehurit.
I.5	Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshtuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.
I.6	Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

### Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik

II.1	Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.
II.2	Përzgjedh informata nga burime të ndryshme për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.
II.5	Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi apo të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu.
II.7	Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

### Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.3	Regjistron në skeda dhe teknika të tjera të veçanta, TI etj., informatat ose faktet a formulat për një temë të caktuar duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë mësimore të tyre.
III.6	Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.7	Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.1	Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.
------	---



## Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.6	Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre.
-----	--

## Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).
VI.6	Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.

## REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET Shkalla 4, klasa VIII

### I. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë

#### 1. Krijimtaria dhe performanca artistike

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

- |    |   |
|----|---|
| 1. | Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë). |
|----|---|

### 2. Gjuha dhe komunikimi artistik

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

- |    |   |
|----|---|
| 1. | Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.             |
| 2. | Komunikojnë me vetëbesim dhe siguri me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.). |

### 3. Relacioni art-shoqëri

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjellas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

- |    |   |
|----|---|
| 1. | Njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror. |
|----|---|

### 4. Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

- |    |  |
|----|--|
| 2. | Përjeton, analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike elementet karakteristike dalluese të kryeveprave artistike të trashëgimisë kulturore dhe artistike (muzikore, pamore, dramë, vallëzim) në kontekst kombëtar dhe më të gjerë. |
| 3. | Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.  |

## II. VLERAT DHE QËNDRIMET QË PROMOVOHEN PËRMES ARTEVE

- Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës;
- Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme;
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia;
- Përqendrimi dhe durimi.

## III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË

- Të vërejturit/të dëgjuarit/aftësitë perceptuese;
- Aftësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë (tingullore, e ngjyrave, e formave, e strukturave, e karaktereve, e lëvizjeve etj.);
- Aftësitë përjetuese artistike;
- Vëmendja dhe memorizimi;
- Vullneti dhe motivacioni;
- Iniciativa dhe interesimi;
- Imagjinata dhe kreativiteti;
- Shkathësitë muzikore;
- Shkathësitë lëvizore;
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar;
- Shkathësia për punë ekipore;
- Të menduarit analitik, kritik dhe kreativ.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<b>Këngë</b> <b>Elementet muzikore</b> <b>Shkrim-leximi muzikor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon format muzikore në veprat e dëgjua të zhanreve e gjinive të ndryshme muzikore;</li> <li>- Zbaton shkrim-leximin muzikor në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre individuale muzikore;</li> <li>- Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim);</li> <li>- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individuale ualishit ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fuqia e muzikës</li> <li>2. Këndojmë në kor</li> <li>3. Kur ka ra kushtrimi në Kosovë</li> <li>4. Shenjat e përsëritjes</li> <li>5. Shenjat e shprehjes</li> <li>6. Shenjat e shartimit</li> <li>7. Mora fjalë</li> </ol> <p>Test vlerësues</p>	8	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia me nxënës në qendër dhe gjithëpërfshirje;</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënimit në qasje të integruar;</li> <li>- Mësimdhënia dhe nxënësia e diferencuar;</li> <li>- Mësimdhënia e bazuar në kompetenca.</li> </ul>	<p>Vlerësimi për të nxënë (formativ);</p> <p>Vlerësimi i të nxënimit (sumativ).</p>	<p>Gjuhët dhe komunikimi;</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi;</p> <p>Matematikë;</p> <p>Edukatë fizike, sporti dhe shëndeti.</p>	<p>Muzika 8;</p> <p>Fletore pune 8.</p>

# PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

## Lënda mësimore: Edukatë Muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: VIII

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.1	Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
I.5	Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshtuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.
I.6	Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

### Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik

II.1	Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.
II.6	Demonstron zgjidhjen e një problemi (matematik, linguistik etj.) bazuar në të dhënat tekstuale ose tekstuale numerike, eksperimentale të detyrës e cila bëhet në klasë/shkollë apo jashtë saj, duke arsyetuar me gojë zbatimin e ecurive përkatëse për arritjen e rezultatit.
II.7	Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme.

### Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.5	Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti, duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas këtë para të tjerëve.
III.6	Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.7	Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.1	Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.
------	--

## Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.6	Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre.
-----	--

## Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).
VI.6	Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.

## REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET Shkalla 4, klasa VIII

### I. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë

#### 1. Krijimtaria dhe performanca artistike

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitete artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

1.	Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë).
----	---

### 2. Gjuha dhe komunikimi artistik

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

1.	Përdorin në mënyrë efektive njohuritë e tyre mbi elementet, proceset dhe teknikat interpretuese dhe krijuese artistike, duke i përdorur ato në mënyrë të vetëdijshme në krijimet e tyre vetjake.
----	--

### 3. Relacioni art-shoqëri

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjellas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

1.	Njeh në mënyrë më të kompletuar kryeveprat artistike në nivel kombëtar dhe botëror.
2.	Demonstron të kuptuarit e ndërlidhjes në mes zhvillimeve shoqërore në periudha të ndryshme kohore dhe ndikimit në stilet, zhanret, format, formacionet dhe elementet shprehëse artistike (p.sh., baroku, klasika, romantizmi etj., dhe karakteristikat dalluese ose specifikat e krijimtarisë artistike muzikore, figurative në këto stile).

## II. VLERAT DHE QËNDRIMET QË PROMOVOHEN PËRMES ARTEVE

- Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës;
- Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme;
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia;
- Përqendrimi dhe durimi.

## III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË

- Të vërejturit/të dëgjuarit/aftësitë perceptuese;
- Aftësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë (tingullore, e ngjyrave, e formave, e strukturave, e karaktereve, e lëvizjeve etj.);
- Aftësitë përjetuese artistike;
- Vëmendja dhe memorizimi;
- Vullneti dhe motivacioni;
- Iniciativa dhe interesimi;
- Imagjinata dhe kreativiteti;
- Shkathësitë muzikore;
- Shkathësitë lëvizore;
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar;
- Shkathësia për punë ekipore;
- Të menduarit analitik, kritik dhe kreativ.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënimit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p><b>Elementet muzikore</b></p> <p><b>Këngë</b></p> <p><b>Elementet e formave muzikore</b></p> <p><b>Gjithë (llojet) muzikore</b></p> <p><b>Tonalitetet</b></p> <p><b>Ngjarje muzikore</b></p> <p><b>Instru-mentet dhe formacionet muzikore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdor elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente muzikore;</li> <li>- Identifikon elementet e formës muzikore në veprat që performojnë dhe dëgjojnë;</li> <li>- Analizon muzikën vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe muzikën skenike, përmes shembujve muzikorë nga krijimtaria muzikore botërore dhe kombëtare;</li> <li>- Përdor elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit;</li> <li>- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit;</li> <li>- Shpreh për veprën e dëgjuar muzikore me vizatim, esë, poezi ose forma të tjera shprehëse artistike.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Ritmi i përzier 5/8</li> <li>Kur hyna n'portë t'kalasë</li> <li>Elemente muzikore</li> <li>Kantata dhe oratorioja</li> <li>Simfonia dhe analiza e saj</li> <li>Ritmi i përzier 7/8</li> <li>Kur këndo për ty moj nënë</li> <li>Shkalla F-Dur</li> <li>Frymëzohemi nga artet e tjera</li> <li>Njohim disa instrumente muzikore</li> </ol> <p>Test vlerësues</p> <p>Përmbledhje njohurish nga gjysmëvjetori i parë</p>	9	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia me nxënës në qendër dhe gjithëpërfshirje;</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënimit në qasje të integruar;</li> <li>- Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar;</li> <li>- Mësimdhënia e bazuar në kompetenca.</li> </ul>	<p>Vlerësimi për të nxënë (formativ);</p> <p>Vlerësimi i të nxënimit (suamtv).</p>	<p>Gjuhët dhe komunikimi;</p> <p>Shkencat e natyrës;</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi;</p> <p>Matematikë;</p> <p>Edukata fizike, sporti dhe shëndeti;</p> <p>Jeta dhe puna.</p>	<p>Muzika 8;</p> <p>Fletore pune 8.</p>

# PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

## Lënda mësimore: Edukatë Muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: VIII

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv

I.1	Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
I.2	Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.
I.5	Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.
I.6	Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

### Kompetenca e të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik

II.1	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror), duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.
II.3	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
II.6	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

### Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.5	Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti, duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas këtë para të tjerëve.
III.6	Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.7	Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV.1	Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.
------	--



### Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

V.6	Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre.
V.9	Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehjet negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo i drogës) etj.

### Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Praktikon të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).
VI.6	Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.

## REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET Shkalla 4, klasa VIII

### I. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë

#### 1. Krijimtaria dhe performanca artistike

Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitetet artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.

1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë).
2. Interpreton në tërësi role (karakteret) të ndryshme.
3. Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).
4. Vizaton, ngjyros, modelon peizazh, portret, kompozicione dy e tridimensionale etj., në mënyrë të lirshme ose me temë të caktuar.

#### 2. Gjuha dhe komunikimi artistik

Nxënësit njohin dhe përdorin elementet dhe parimet e gjuhës artistike, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe në vallëzim.

1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta.

#### 3. Relacioni art-shoqëri

Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjellas në kontekstin historik, social dhe kulturor.

3. Prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global, lokal e kombëtar.

#### 4. Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik

Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.

1. Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.
3. Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.

## II. VLERAT DHE QËNDRIMET QË PROMOVohen PËRMES ARTEVE

- Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës;
- Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare;
- Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme;
- Bashkëpunimi dhe përgjegjësia;
- Përqendrimi dhe durimi.

## III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË

- Të vërejturit/të dëgjuarit/aftësitë perceptuese;
- Aftësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë (tingullore, e ngjyrave, e formave, e strukturave, e karaktereve, e lëvizjeve etj.);
- Aftësitë përjetuese artistike;
- Vëmendja dhe memorizimi;
- Vullneti dhe motivacioni;
- Iniciativa dhe interesimi;
- Imagjinata dhe kreativiteti;
- Shkathësitë muzikore;
- Shkathësitë lëvizore;
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar;
- Shkathësia për punë ekipore;
- Të menduarit analitik, kritik dhe kreativ.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p><b>Krijuesit dhe performuesit</b></p> <p><b>Kreativitet muzikor</b></p> <p><b>Këngë</b></p> <p><b>Elementet muzikore</b></p> <p><b>Tonalitetet</b></p> <p><b>Interpretim në instrument</b></p> <p><b>Ngjarje muzikore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shprehjet me lëvizje/vallëzim, shprehjet letrare e figurative inspironuar nga muzika e dëgjuar;</li> <li>- Analizon karakteristikat tingëllore dhe funksionale të instrumenteve të ndryshme muzikore;</li> <li>- Njeh vepra dhe krijues të shquar të muzikës artistike kombëtare;</li> <li>- Përdor elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit;</li> <li>- Njeh parimin e tonaliteteve të ndryshme muzikore dhe simbolet e tyre;</li> <li>- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit;</li> <li>- Shprehjet për karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin, përmbajtjen) me gojë, me shkrim, forma vizuale, prezantim me teknologji bashkëkohore, teknologjinë muzikore etj.;</li> <li>- Shfaqin këngët dhe luan pjesë instrumentale sipas imitimit ose me tekst notal, në zhanre të ndryshme, individualisht dhe në grupe.</li> </ul>	<ol style="list-style-type: none"> <li>18. Interpretues të shquar</li> <li>19. Vallet tona popullore</li> <li>20. Kur bien fyelli, çiftelia</li> <li>21. Ritmi i përzier 9/8</li> <li>22. Kur filloi drita me dalë</li> <li>23. Shkalla d-mol</li> <li>24. Luajmë në instrument</li> <li>25. Muzika dhe loja</li> </ol> <p>Test vlerësues</p>	11	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia me nxënësit në qendër dhe gjithëpërfshirje;</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënimit në qasje të integruar;</li> <li>- Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar;</li> <li>- Mësimdhënia e bazuar në kompetenca.</li> </ul>	<p>Gjuhët dhe komunikimi;</p> <p>Shkencat e natyrës;</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi;</p> <p>Matematikë;</p> <p>Edukata fizike, sporti dhe shëndeti.</p>	Muzika 8; Fletore pune 8.

# PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

## Lënda mësimore: Edukatë Muzikore

Fusha e kurrikulës: Artet

Klasa: VIII

### Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ temave: I. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv*

I.1	Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
I.6	Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikun adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.

### Kompetenca e të nxënit - Nxënës i suksesshëm

III.6	Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të performuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj.
III.7	Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënit të temës së dhënë, duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të papaqarta.

### Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

IV	Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit, duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme.
----	--

### Kompetenca personale - Individ i shëndoshë

VI.6	Dallon atributet e mirësjelljes nga ato përçmuese ndaj të tjerëve gjatë punës në grup ose në situata emocionale dhe propozon masat për parandalimin/kapërcimin e tyre.
VI.9	Reagon ndaj sjelljeve asociale të moshatarëve, duke identifikuar shkaqet e shfaqjes dhe pasojat e mundshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit nga dukuritë dhe shprehitë negative (p.sh., përdorimi i duhanit, i alkoolit apo i drogës) etj.

### Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

VI.6	Identifikon paragjykimet apo dukuritë jo të mira në klasë, në shkollë apo në komunitet, merr qëndrim ndaj tyre, duke propozuar veprime konkrete për luftimin e tyre.
------	--

## REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS ARTET Shkalla 4, klasa VIII

I. Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë	
<b>1. Krijimtaria dhe performanca artistike</b>	
Nxënësit, sipas prirjes, dispozitave dhe interesimit individual, zhvillojnë shkathtësi të ndryshme për interpretim artistik në aktivitetet artistike muzikore, pamore, vallëzim, aktrim etj.	
1.	Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë).
2.	Interpreton në tërësi role (karakteret) të ndryshme.
3.	Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).
5.	Krijon këngë dhe shoqërimi instrumentale në zhanre të ndryshme (popullore, artistike, argëtuese).
7.	Krijon dhe kontribuon në realizimin skenik të teksteve për shfaqje të ndryshme (dramë, komedi, muzikë).

3. Relacioni art-shoqëri	
Nxënësit kuptojnë zhvillimin dhe ndikimin e artit në shoqëri dhe anasjellas në kontekstin historik, social dhe kulturor.	
3.	Prezanton disa nga përfaqësuesit më të spikatur të stileve e periudhave artistike në nivel global, lokal e kombëtar.

4. Çmuarja dhe vlerësimi estetiko-artistik	
Nxënësit aplikojnë gjykim dhe vlerësim kritik të veprave artistike në muzikë, arte pamore, art dramatik dhe vallëzim, duke u bazuar në të kuptuarit e filozofisë së artit dhe parimet estetike.	
1.	Çmon dhe vlerëson krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve, duke analizuar formën, elementet shprehëse dhe mënyrat e teknikave të përdorimit të tyre në funksion të shprehjes artistike.
3.	Çmon diversitetin kulturor në rajon dhe më gjerë.

II. VLERAT DHE QËNDRIMET QË PROMOVohen PËRMES ARTEVE	
<ul style="list-style-type: none"><li>• Qëndrimi pozitiv ndaj artit dhe së bukurës;</li><li>• Qëndrimi pozitiv ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare;</li><li>• Qëndrimi pozitiv dhe respekti ndaj kulturave të ndryshme;</li><li>• Bashkëpunimi dhe përgjegjësia;</li><li>• Përqendrimi dhe durimi.</li></ul>	

### III. AFTËSITË DHE SHKATHËSITË

- Të vërejturit/të dëgjuarit/afhtësitë perceptuese;
- Afhtësia për të vërejtur dhe për të dalluar ritmin dhe harmoninë (tingullore, e ngjyrave, e formave, e strukturave, e karaktereve, e lëvizjeve etj.);
- Afhtësitë përjetuese artistike;
- Vëmendja dhe memorizimi;
- Vullneti dhe motivacioni;
- Iniciativa dhe interesimi;
- Imagjinata dhe kreativiteti;
- Shkathësitë muzikore;
- Shkathësitë lëvizore;
- Komunikimi dhe të shprehurit artistik multidisiplinar;
- Shkathësia për punë ekipore;
- Të menduarit analitik, kritik dhe kreativ.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p><b>Këngë</b></p> <p><b>Krijësit dhe performuesit</b></p> <p><b>Zhanret muzikore</b></p> <p><b>Kreativitet muzikor</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njeh vepra dhe krijues të shquar të muzikës artistike kombëtare;</li> <li>- Krijon tërësi të reja muzikore në bazë të ritmit, tekstit poetik etj.;</li> <li>- Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit;</li> <li>- Shfrytëzon teknologjinë bashkëkohore (dhe atë muzikore) sipas interesimit dhe prirjes për të krijuar shprehje origjinale muzikore.</li> </ul>	<p>26. Luleborë</p> <p>27. Njohim kompozitorët tanë</p> <p>28. Muzika zbatimëse (e lehtë)</p> <p>29. Eja në Prishtinë</p> <p>30. Muzika xhaz</p> <p>31. Muzika rok</p> <p>32. Blowing in the Wind</p> <p>33. Videoklipi muzikor</p> <p>34. Krijojmë një këngë</p> <p>35. Muzika e filmit</p> <p>Test vlerësues</p> <p>Përmbledhje njohurish nga gjysmëvjetori i dytë</p>	11	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia me nxënësit në qendër dhe gjithpërfshirje;</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënit në qasje të integruar;</li> <li>- Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar;</li> <li>- Mësimdhënia e bazuar në kompetenca.</li> </ul>	<p>Vlerësimi për të nxënë (formativ);</p> <p>Vlerësimi i të nxënit (sumativ).</p>	<p>Gjuhët dhe komunikimi;</p> <p>Shkencat e natyrës;</p> <p>Shoqëria dhe mjedisi;</p> <p>Matematikë.</p>	<p>Muzika 8;</p> <p>Fletore pune 8.</p>

# Mësimi 1

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Këngë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Interpreton në performanca të ndryshme të kombinuara (muzikë, dramë, vallëzim).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6, II-1, II-7, V-6 ; VI-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 4.2; 4.3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Fuqia e muzikës

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Shpreh emocionet përmes dëgjimit;
- Përkufizon termin *muzikë*.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Mësimdhënësi/ja lëshon këngën “Perëndeshë e bukur je”, interpretuar nga Nexhmie Pagarusha dhe Liliana Çavolli. Pasi ta dëgjojnë atë, pyeten nxënësit:

- *Çfarë mund të thoni për fuqinë e interpretimit të tyre?*  
Pas përgjigjeve të dhëna, bëhet e ditur njësia që do të zhvillohet.

Njësia 1

## Fuqia e muzikës



**Dëgjojmë**

Dëgjoni “Perëndeshë e bukur je”, të interpretuar nga Nexhmie Pagarusha dhe Liliana Çavolli. Çfarë mund të thoni për fuqinë e interpretimit të tyre?

Ti qasësh botës së tingujve do të thotë të lidhesh me një univers stimujsh: nga të perceptuarit të të socializuarit, nga të dëgjuarit të të shprehurit, nga të praktikuarit vokale dhe instrumental të të vepruarit në mënyrë krijuese.



### Muzika, gjuhë universale

Muzika është një gjuhë e veçantë, e përbërë nga tinguj të prodhuar dhe të organizuar nga njeriu për t’u shprehur dhe për të komunikuar. Gjuha muzikore mund të dialogojë tërthorazi me të gjitha gjuhët e tjera dhe kodet komunikuese. Në këtë proces, ajo ndërthur lidhjet me fjalën, imazhin dhe lëvizjen, duke kapërcyer barrierat kulturore dhe duke përkrahur integrimin.

Ndryshe nga gjuhët e tjera, muzika na përcjell nënkuptime që nuk janë të përpikta, përveç rasteve të këngëve të cilat janë ngushtësisht të lidhura me tekstin përkatës. Forca e gjuhës së muzikës qëndron pikërisht në faktin që ajo ngjall llojlloj emocioneesh. Këto emocione janë të lidhura ngushtë me karakteristikat e secilit prej nesh dhe me situatat e ndryshme në të cilat ndodh përvoja muzikore.

### Muzika, “shoqë jete”

Muzika na shoqëron që prej ditës kur kemi lindur. Ajo ndërvepron me përvojat tona personale dhe kolektive.

Muzika është pikë takimi dhe komunikimi social, por është edhe hulumtim i brendshëm, edukim i vetvetes dhe ballafaqim mes përvojës e kulturës vetjake me përvojat dhe kulturat e të tjerëve. Ajo tregon se cilët jemi, tregon një pjesë të personalitetit tonë, të kulturës sonë dhe të interesave që kemi.



10



E quajtëm "shoqe të jetës", sepse muzika na shoqëron në momente të ndryshme të jetës, qoftë gëzimi, qoftë hidhërimi. Ajo na bën të mendojmë dhe na nxit emocione të ndryshme.

Mbi të gjitha, muzika është një formë arti, përmes së cilës autorët shprehin veten, idetë dhe mendimet e tyre.

Nga kjo kuptojmë që muzika do të na shoqërojë përgjatë gjithë jetës për të na ndihmuar që të ritemi dhe ta shprehim veten.



#### Dëgjim dhe bashkëbisedim

Nga baleti "Arrëthyesi" i Çajkovskit, dëgjoni suitën "Vallja e zanës së kumbullës së sheqerit" dhe bashkëbisedoni rreth emocioneve të përjetuara gjatë dëgjimit të saj.



#### Detyrë

Një nga violinistët dhe dirigjentët më të njohur në botë, Salvatore Akardo, ka thënë: "Muzika është pikësëpari emocion dhe, meqenëse pa emocione nuk ka jetë, përfundimisht muzika është jetë".

► Gjeni thënie të tjera për muzikën dhe komentojni ato në klasë.



11



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi ndahet në dy paragrafë.

Nxënësit e lexojnë paragrafin e parë (Muzika, gjuhë universale), dhe më pas, së bashku me mësimdhënësin e komentojnë atë.

Në të njëjtën mënyrë vepohet edhe me paragrafin e dytë (Muzika, shoqe jete).

Kërkohet nga nxënësit që ta komentojnë thënien e dirigjentit Salvatore Akardo: "Muzika është pikësëpari emocion dhe, meqenëse pa emocione nuk ka jetë, përfundimisht muzika është jetë."



## Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit shkruajnë në mënyrë të pavarur nga një ese të shkurtër me temën: "Muzika, pjesë e pandashme e përditshmërisë sonë."

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 5-6.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 2

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Elementet muzikore

#### Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon format muzikore në veprat e dëgjua të zhanreve e gjinive të ndryshme muzikore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 5, II-5, IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 4.1; 4.3.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Këndojmë në kor

#### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon muzikën vokale nga ajo instrumentale;
- Klasifikon koret.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Nxënësve u lëshohet koralja “O Fortuna” e veprës “Karmina Burana”, të Karl Orf. Pasi ta kenë dëgjuar, pyeten:

- Çfarë ju bëri përshtypje?

Përmes pyetjes, arrihet deri te njësia që do të zhvillohet.


Njësia 2

### Këndojmë në kor



Dëgjojmë

Dëgjoni koralen “O Fortuna” të veprës “Karmina Burana” të Karl Orfit. Çfarë ju bëri përshtypje?



Çelësat e mësimit

zëra femërorë zëra të bardhë kor zëra mashkullorë

Të jesh pjesë e një grupi të organizuar që këndon, duhet të ndjekësh me përpikëri këshillat dhe udhëzimet e drejtuesit, të mësosh lëvizjet e duhura të trupit e fytyrës, frymëmarrjen e duhur, shpirtimin e saktë dhe shprehës të fjalëve dhe të bësh shumë praktikë.

#### Çfarë është kori?

Kur këndojmë së bashku në klasë, formojmë një kor. Edhe pse nuk është një kor profesionistësh, është gjithsesi një shembull i mirë i të kënduarit në kor. Është një moment i rëndësishëm në të cilin të gjithë përqendrohemi dhe tregojmë vëmendje për të marrë pjesë në mënyrë aktive.

Të kënduarit në kor është një mënyrë për të qëndruar së bashku, për të dëgjuar njëri-tjetrin, për të përmirësuar intonacionin, për t'u shprehur etj.

Në kor përdoren **zërat femërorë**, **zërat mashkullorë** dhe **zërat e bardhë**, por me një shtrirje të përbajtur krahasuar me të kënduarit solo.



► Kori i Filarmonisë së Kuovës

12

## Llojet e koreve

Sipas zërave që e përbëjnë, kori mund të jetë dy llojesh:

Me zëra të njëjtë (ose të barabartë)	Me zëra të pabarabartë (ose të përzier)
<ul style="list-style-type: none"><li>• vetëm me zëra mashkullorë,</li><li>• vetëm me zëra femërorë,</li><li>• vetëm me zëra fëmijësh (zëra të bardhë).</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• me zëra mashkullorë dhe femërorë,</li><li>• me zëra mashkullorë, femërorë dhe zëra fëmijësh.</li></ul>

## Kori i fëmijëve

Kori i fëmijëve është një grup i organizuar fëmijësh që këndojnë. Pra, ai përbëhet nga zërat e fëmijëve ose nga zërat e bardhë. Një shembull i tillë është kori i shkollës, i cili përbëhet nga nxënës dhe nxënëse që zotërojnë cilësi të mira vokale dhe kanë dëshirë të këndojnë.

Koristët të cilët kanë zë të lartë dhe timbër të pastër, këndojnë zërin e parë. Ata që kanë timbër më të thellë dhe që nuk këndojnë tone të larta, këndojnë zërin e dytë.

Kori i fëmijëve mund të interpretojë kompozime njëzërëshe, dyzërëshe, trezërëshe dhe katërzërëshe.



▶ Kori i fëmijëve "Okarina" gjatë interpretimit të vepërës "Karmina Burana" në Prishtinë, 2022

### Detyrë

Dëgjoni "Këngë moj", të interpretuar nga kori Siparantun, nën dirigjimin e Memli Kelmendit, dhe:

- ▶ përshkruani atmosferën që përcolli kjo pjesë te ju,
- ▶ hulumtoni rreth këtij kori dhe veprimtarisë së tij.

13



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja vendos katër foto të koreve të ndryshme në tabelë: kori i përzier; kori i femrave; i meshkujve dhe i fëmijëve.



Nxënësit e lexojnë dhe e komentojnë mësimin të ndarë në paragrafë. Po ashtu, i analizojnë edhe fotografitë e shfaqura.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit, të udhëzuar nga mësimdhënësi, do të punojnë detyrën në librin bazë në faqen 13.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë faqen 7 në fletoren e punës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 3

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Këngë

#### Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë) sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 4.2.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë

#### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Respekton rregullat e këndimit të drejtë dhe të bukur;
- Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD, piano/sintisajzer.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja ua lëshon nxënësve për ta dëgjuar këngën “Besa besë, besën ta kam dhanë”, e cila gjendet në linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=8fbUyRee3w8>.

Përmes kësaj kënge, bëhet e ditur njësia mësimore që do të zhvillohet.

Njësia 3

### “Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë”



Dëgjojmë

Dëgjoni këngën patriotike “Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë” dhe komentoni mesazhin që përcjell.

“Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë” është një këngë patriotike e kënduar në kohën e Rilindjes shqiptare nga luftëtarët e kohës.

Pas çlirimit të Kosovës në vitin 2000, një version i kësaj kënge, i përpunuar nga Rauf Dhomi, u propozua nga kreu i atëhershëm i Kosovës, Ibrahim Rugova, si himn i Kosovës.

#### Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë

**I**  
Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë  
Kur ka ra kushtrimi n’Kosovë  
Janë bashku’qytete, katunde  
Dhe bjeshkët me malësorë  
Janë bashku’qytete, katunde  
Dhe bjeshkët me malësorë

**II**  
Mirë luftojkan Pejë e Gjakovë  
Mirë luftojkan Pejë e Gjakovë  
Mirë luftoi Prizreni, Prishtina e Llapi me Rugovë  
Mirë luftoi Prizreni, Drenica e Llapi me Rugovë

**III**  
Ç’na u mbush kjo tokë me dëshmorë  
Ç’na u mbush kjo tokë me dëshmorë  
Të na rrhojë e jona Kosovë, të na rrhojë o përgjithmonë  
Të na rrhojë e jona Kosovë, të na rrhojë o përgjithmonë.



14

### "Kur ka ra kushtrimi n'Kosovë"

Kur ka ra kush-tri - mi n'Ko - sov' kur ka ra kush-tri - mi n'Ko - sov' ...

5 Janë bash-ku qy - te - te ka - tun - de dhe bje-shkët me mal' - sor' ... Mir' luf - toj-kan Pej' e Gja-

9 kov' Mir' luf - toj-kan Pej' e Gja - kov' Mir' luf - toi Pri - zre - ni Dre-

13 ni - ca e Lla-pi me Ru - gov' Mir' luf-toi Pri-zre - ni Dre - ni - ca e Lla-pi me Ru-

17 gov' C'na u mbush kjo tokë me dësh - mor' Të na rrhojë e jo - na Ko-

21 sov' Të na rrhojë e jo - na Ko - sov' të na rrhojë o për-gjith-mon' për ...

25 gjith - mon' ...

- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?

15



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;

Leximi dhe analiza e vargjeve;

Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësve;

Demonstrimi i tërësishëm i këngës;

Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që këngën ta këndojnë drejt, saktë, me frymëmarrje të duhur dhe artikulum të qartë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë në fletore pune, faqet 25-26.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

# Mësimi 4

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Shkrim-leximi muzikor

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
Zbaton shkrim-leximin muzikor në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre individuale muzikore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shenjat e përsëritjes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon shenjat e përsëritjes;
- Respekton shenjat e përsëritjes gjatë këndimit/interpretimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, projektori, partitura.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja paraqet në projektor partitura muzikore që përmbajnë shenjat e përsëritjes. Më pas, pyeten nxënësit se çfarë funksioni mund të kenë këto shenja.

Njësia 4

## Shenjat e përsëritjes

Shenjat e përsëritjes përdoren me qëllim shmangien e rishkrimit të copëzave të një pjesë muzikore që përsëriten pa variacione në momente të ndryshme të ekzekutimit të pjesës. Këto shenja i ndihmojnë kompozitorët për ta shkruar më shpejt një partiturë muzikore, kurse muzikantëve ua lehtësojnë leximin e saj. Në vijim do të njohim disa prej tyre.

**Çelësat e mësimimit**  
shenja e kthimit kroçe shenja e përsëritjes së masës da capo al. fine senja

### Shenja e kthimit

Shenja e kthimit tregon se një pjesë ose një copëz e saj duhet përsëritur nga fillimi dhe paraqitet me këtë shenjë:

 shenja e kthimit


Dy pikat qëndrojnë në të djathtë të vijës ndarëse dyshje.

Shenja e kthimit mund të paralajmërohet nga:

 shenja e fillimit të kthimit

Dy pikat qëndrojnë në të djathtë të vijës ndarëse dyshje.

Masat që ndodhen mes këtyre dy shenjave janë ato masa që duhen përsëritur:



Pas kësaj mase, përsëritet nga e para.



Pas kësaj mase, përsëritet nga shenja e parë.



Shenja e kthimit mund të shoqërohet nga këto dy shenja:

1.  2. 

16

Këto shenja tregojnë që gjatë përsëritjes nuk duhen luajtur masat e treguara nga shenja e parë (që mban numrin 1), por duhen luajtur masat e treguara nga shenja e dytë (që mban numrin 2).



### Shenja të tjera të përsëritjes

Në një pjesë muzikore mund të gjejmë edhe shënimin "D.C. al Fine". Në këtë rast, duhet të përsëritim të gjitha masat nga fillimi (*capo*) deri te masa e shënuar me fjalën "Fine".



*Nga kjo masë përsërite nga fillimi deri në fund.*

Për të treguar se duhet përsëritur masa e mëparshme, përdoret kjo shenjë: %



*Masa që duhet përsëritur.*

Shenja % (senjo), e përdorur së bashku me shenjën ⊕ (kroçe), tregon se duhet përsëritur copëza e pjesës që qëndron mes këtyre dy shenjave.



*Përsëriten masat që përshihen mes dy shenjave.*



Detyrë

► Lexoni fjalët që përmban rubrika "Çelësat e mësimi", shikoni shenjat e mëposhtme dhe shpjegoni me shkrim se çfarë tregojnë dhe si përdoren.



17

Mësimdhënësi/ja gjithashtu jep sqarime edhe për përdorimin e shenjave "senjo" e përdorur së bashku me shenjën "kroçe".



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit e kryejnë detyrën në faqen 17 në librin bazë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 10.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

SHENJAT E PËRSËRITJES	KUPTIMI
	Shenja e kthimit.
	Shenja e fillimit të kthimit.
	Masat që ndodhen në mes të këtyre dy shenjave janë ato masa që duhen përsëritur.
	Këto shenja tregojnë që gjatë përsëritjes nuk duhet luajtur masat e treguara nga shenja e parë (që mban numrin 1), por duhet luajtur masa e treguar nga shenja e dytë (që mban numrin 2).
	Në këtë rast, duhet të përsëritim të gjitha masat nga fillimi ( <i>capo</i> ) deri te masa e shënuar "Fine".

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Shkrim-leximi muzikor

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Zbaton shkrim-leximin muzikor në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre individuale muzikore. Përdor elementet e ndryshme të formave muzikore në krijimet e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; II-1, 2; III-3; VI-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 2.2; 2.4; 4.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shenjat e shprehjes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon shenjat e shprehjes;
- Respekton shenjat e shprehjes gjatë këndimit/interpretimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, projektori, partitura.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**

Mësimdhënësi/ja paraqet në projektor partitura muzikore që përmbajnë shenjat e shprehjes: diezis, bemol dhe bekuader. Më pas, pyeten nxënësit se çfarë funksioni mund të kenë këto shenja.

## Shenjat e shprehjes

Shenjat e shprehjes janë shenja që shkruhen mbi një notë muzikore dhe që përdoren nga muzikantët në kompozimet e tyre. Shenjat e shprehjes tregojnë se si duhet të luhet ajo notë. Në vijim do të njihemi me disa prej tyre.



### Korona

Shenja e koronës vendoset mbi një notë muzikore ose mbi një pushim. Ajo tregon që tingulli i notës ose pushimi zgjatet më shumë se sa vlera që kanë, në varësi të dëshirës së ekzekutuesit të pjesës muzikore.



### Stakato

Shenja e stakatos është një pikë e cila vendoset mbi ose nën një notë muzikore. Ajo tregon që nota në fjalë duhet luajtur në mënyrën stakato, çka do të thotë se tingulli i saj do të jetë më i shkurtër se normalisht.



### Theksi

Shenja e theksit vendoset mbi ose nën një notë muzikore. Ajo tregon që nota në fjalë duhet luajtur në mënyrë markato, ose me më shumë impuls se të tjerat, çka do të thotë se tingulli i saj do të jetë më i theksuar se normalisht.





**Punojmë së bashku**

Identifikoni shenjat e shprehjes në pjesën e mëposhtme. Tregoni funksionin e secilës prej tyre. Lexoni notat mbi ose nën të cilat janë vendosur këto shenja.



**Detyrë**

Gjeni këngë ose pjesë muzikore, në të cilat gjejnë pasqyrim shenjat e shprehjes.



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

SHENJAT E PËRSËRITJES	KUPTIMI
	<b>Korona</b> – Tregon që tingulli i notës ose pushimi zgjaten më shumë sesa vlera që e kanë.
	<b>Stakato</b> – Tregon që tingulli i saj do të jetë më i shkurtër se normalisht.
	<b>Theksi</b> – Tregon që tingulli i saj do të jetë më i theksuar se normalisht.

Mësimdhënësi/ja vendos në projektor partitura muzikore, ku paraqiten shenjat e shprehjes në fjalë, e, më pas, i demonstroi praktikisht ato.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit**

Nxënësi e kryen detyrën në faqen 19 në librin bazë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësim i vazhdueshëm.

**Detyrë:**

Të plotësojë faqen 11 në fletoren e punës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

# Mësimi 6

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Shkrim-leximi muzikor

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Zbaton shkrim-leximin muzikor në përputhje me moshën dhe aftësitë e tyre individuale muzikore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; II-1, 2; III-3; VI-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shenjat e shartimit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon shenjat e shartimit;
- Respekton shenjat e shartimit gjatë këndimit/interpretimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, projektori, partitura.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja paraqet në projektor partitura muzikore që përmbajnë shenjat e shartimit: diezis, bemol dhe bekuadër. Më pas, pyeten nxënësit se çfarë funksioni mund të kenë këto shenja.

Njësia 6

## Shenjat e shartimit

Shenjat e shartimit janë shenja të cilat modifikojnë tingullin e notave. Ato vendosen në pentagram ose para vetë notave dhe modifikojnë ekzekutimin e këtyre notave.

Shenjat e shartimit modifikojnë tingujt natyrorë, Do-Re-Mi-Fa-Sol-La-Si, duke e ngritur ose duke e ulur intonacionin e tyre.



### Shenjat e thjeshta të shartimit


Më të përdorurat nga shenjat e thjeshta të shartimit janë:

**# diezisi**, i cili tregon se tingulli natyror ngrihet me gjysmë toni,

**b bemoli**, i cili tregon se tingulli natyror ulët me gjysmë toni,

**♯ bekuadër**, i cili tregon se tingulli, i shartuar më parë me një diezis ose me një bemol, duhet të kthehet në gjendjen e tij natyrorë.

Në figurën e mëposhtme mund të shohim se si tasteve të zeza të pianos u korrespondojnë notat e shartuara.



Shartimet mund të jenë të përkohshme dhe të përhershme.

**Shenja e shartimit të përkohshëm** vendoset në të majtë të notës që duhet shartuar. Ky lloj shartimi ka efekt mbi të gjitha notat me të njëjtin emër dhe me të njëjtin lartësi që përmban masa. Ai vlen vetëm për masën në të cilën ndodhen këto nota.



20

Shenja e shartimit të përhershëm vendoset në fillim të pjesës muzikore, mes çelësit dhe kohës, në pozicionin e notës. Ky lloj shartimi ka efekt mbi të gjithë kohëzgjatjen e kompozimit, mbi të gjitha notat me të njëjtin emër dhe me lartësi të çfarëdoforme.



### Shenjat dyshe të shartimit

Përveç shenjave të thjeshta të shartimit, janë edhe shenjat dyshe të shartimit, të cilat mund të klasifikohen në këtë mënyrë:

- **dopio diezis** ✖, i cili tregon se tingulli natyror duhet ngritur me një ton,
- **dopio bemol** ≡, i cili tregon se tingulli natyror duhet ulur me një ton,
- **dopio bekuadër** ≡, i cili tregon se shartimet dyshe (dopio) duhen anuluar.

### Punojmë së bashku

► Në partiturën e mëposhtme gjeni shenjat e shartimit që janë përdorur. Shpjegoni se çfarë tregon secila prej tyre.



### Detyrë

► Lidhni me shigjetë.

- |             |  |
|-------------|--|
| Diezis ●    | ● ul tingullin me gjysmë toni.           |
| Bemol ●     | ● risjell tingullin në gjendje natyrale. |
| Bekquadër ● | ● ngre tingullin me gjysmë toni.         |

21



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

SHENJAT E SHARTIMIT	KUPTIMI
#	<b>Diezis</b> - Tingulli ngrihet për një gjysmë ton.
b	<b>Bemol</b> - Tingulli zbritet për një gjysmë ton.
h	<b>Bekquadër</b> - E kthen tingullin në gjendjen e tij natyrore.
✖	<b>Dopio Diez</b> - Tingulli ngrihet për një ton.
≡	<b>Dopio Bemol</b> - Tingulli zbritet për një ton.

Mësimdhënësi/ja vendos në projektor partitura muzikore, ku paraqiten shenjat e shartimit në fjalë, e, më pas, demonstroi praktikisht në tastaturë të pianos dhe tregon funksionin e tyre.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit e kryejnë detyrën në faqen 21 të librit bazë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë faqen 12 në fletoren e punës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Këngë

### Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.5; 3.1; 4.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mora fjalë

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Respekton rregullat e këndimit të drejtë;
- Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, foto e Adem Jasharit, piano/sintisajzer.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**

Mësimdhënësi/ja vendos në tabelë një foto me figurën e komandantit legjendar Adem Jashari dhe kërkon nga nxënësit që t'i shprehin njohuritë që kanë për të.



## "Mora fjalë"



Dëgjojmë

Dëgjoni këngën "Mora fjalë". Përkruani ndjesitë tuaja gjatë dëgjimit.

Kënga "Mora fjalë" është kushtim për legjendarin Adem Jashari dhe ngjan me këngët antike që u këndoheshin heronjve me përmasa hyjnore. Vargjet dhe muzika e kësaj kënge janë krijuar nga kompozitori Naim Gjoshi dhe janë interpretuar nga këngëtarja Shkurte Fejza.

### "Mora fjalë"

*Mora fjalë, mora fjalë e mora vargun*

*Mora qarkun me i thur kangë*

*Me i thur kangë bashkëlegjendarit, t'i këndoj*

*T'i këndoj Adem Jasharit, t'i këndoj*

*Tash sa vjet*

*Tash sa vjet s'e sheh Prekazin dhe Recakun, tash sa vjet*

*Tash sa vjet s'e sheh Drenicën, tash sa vjet*

*Tash sa vjet dhe Mitrovicën, tash sa vjet.*

*Mora fjalë, mora fjalë e mora vargun*

*Mora qarkun me i thur kangë*

*Me i thur kangë bashkëlegjendarit, t'i këndoj*

*T'i këndoj Adem Jasharit, t'i këndoj*

*E t'i them*

*E t'i them se giaku i tij është vetë liria që ka*

*ardhë*

*Në Kosovë e brigjeve' të Drinit kjo liri*

*ia flladiti ballin trimit, ia flladiti.*

*Çohu Adem*

*Çohu po të thonë zogitë e malit dhe bilbilat*

*Çohu Adem*

*Po thonë lulet trëndafilat, çohu Adem*

*Po thonë kangët, thonë dhe trimat, çohu Adem*

*Çohu shpejt, çohu shpejt mos rri te varri*

*Thotë nanëloka, çohu se mjaft*

*Ta flladiti ballin toka, çohu se ty*

*Të kërkon e tanë Kosova, ty Adem.*



**"Mora fjalë"** Teksti dhe muzika: Naim Gjoshi

Intro Canto

Mo-ra fjalë Mo-ra fjalë emora var-gun-mo-ra qar-kun  
 me i thur ka - ngë - Me i thur ka - ngë bashk' lo - gjen - dar - it t'i kën -  
 doj - t'i kën doj A - dem Ja sha - rit - t'i kën - doj taash sa  
 vjet - Taash sa vjet se sbe Pre - ka - zin dhe Re - ça - kun taash sa vjet -  
 taash sa vjet s'e shih Dre - ni - cën taash sa vjet Taash sa vjet  
 dhe Mi - tro - vi - cën taash sa vjet -

- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?



Mësojmë më tej

« Historia e Adem Jasharit dhe e familjes së tij është një ndër unikalet në gjithë globin. Ata rezistuan deri në momentin e fundit, u sakrifkuan me vetëdije, luftuan për 52 orë, nga 5 marsi deri më 7 mars 1998. Pesëdhjetë e gjashtë veta humbën jetën. Tetëmbëdhjetë ishin gra dhe dhjetë prej tyre fëmijë nën 16 vjeç. Adem Jashari lindi në përvjetorin e pavarësisë, më 28 nëntor 1955 dhe ra ditën e arsimit shqip, më 7 mars 1998. Si sot, 25 vjet. Në themelet e sakrificës më të madhe që ndonjë familje shqiptare ka bërë ndonjëherë, qëndron pavarësia e Kosovës. »

Blendi Fevziu, gazetar dhe shkrimtar

23



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;
Leximi dhe analiza e vargjeve;
Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësve;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që ta këndojnë këngën drejt (saktë), me frymëmarrje të duhur dhe artikullim të qartë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 13-14.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

# Mësimi 8

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Elementet muzikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Përdor elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente muzikore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 5; II-1; III-5, 6, 7; IV-1, V-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ritmi i përzier 5/8

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Demonstron ritmin 5/8;
- Dallon ritmin 5/8 gjatë dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

U lëshohet nxënësve kënga "O sa bukur paske çilë". Pasi ta kenë dëgjuar, pyeten:  
 - Çfarë mund të thoni për ritmin e saj?

Njësia 8

## Ritmi i përzier 5/8



Dëgjoni këngën "O sa bukur paske çilë".



### Ritmet e përziera

Përveç ritmeve të thjeshta, në muzikë ka edhe ritme të përbëra dhe të përziera.

Ritmet e përziera formohen nga bashkimi i dy ose më shumë ritmeve të thjeshta me numër kohësh të ndryshme.



Muzika jonë popullore është shumë e pasur me ritme nga më të ndryshmet, por më së shumti ndërtohet mbi ritmet e përziera: 5/8, 7/8, 9/8.



► Ansambli popullore

### Ritmi 5/8


Ritmi i përzier 5/8 paraqitet me dy lëvizje, si ritmi i thjeshtë 2/4, por lëvizja që mban tri notat tetëshe është më e gjatë.




24

Ky ritëm formohet nga bashkimi i dy masave të thjeshta:  $\frac{2}{8} + \frac{3}{8} = \frac{5}{8}$ . Pra, ai përbëhet nga dy lëvizje jositmetrike, të cilat e sjellin këtë ritëm në dy variante.

Varianti I

$$\frac{2}{8} + \frac{3}{8} = \frac{5}{8}$$


Varianti II

$$\frac{3}{8} + \frac{2}{8} = \frac{5}{8}$$


Në skemat e mësipërme, theksi në lëvizjen e parë është i fortë, ndërsa në lëvizjen e dytë, theksi është i butë.

### Detyrë

- Lexoni ushtrimin ritmik në kohën 5/8. Shoqërojeni ushtrimin me lëvizje dore ose me instrument.



- Këndoni ose luani në instrument ushtrimin melodik në kohën 5/8.





25




## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Fillimisht mësimdhënësi/ja e interpreton këngën “Lul’ e kuqe” në tetë takte.



1. Nxënësit ndahen në dy grupe: njëri grup e këndon këngën, kurse tjetri e shënon metrin e saj, apo mund të fillojë edhe ligjërimin ritmik të vargjeve të këngës me këtë figurë ritmike:




E gjithë kjo procedurë kryhet me ndihmën e mësimdhënësit/es.

2. Interpretimi shoqërohet me lëvizjet e dorës poshtë-lart. Kjo mund të konkretizohet edhe me shigjeta nën vargje, të cilat shënohen në tabelë nga mësimdhënësi/ja.

Lul' e	ku-qe	lul' boj'	pem be	i-ve	o-ve	e-ve	o-ve	
↓	↑	↓	↑	↓	↑	↓	↑	↓
↑	↓	↑	↓	↑	↓	↑	↓	↑

Më pas, arrihet në përfundim se rrokjet në lëvizjet poshtë janë më të shkurtra, kurse ato lart janë më të gjata.

Në fund, rrokjet zëvendësohen me nota përkatëse dhe vihet në përfundim se kënga është në masën 5/8.




### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

Kërkohet nga nxënësit që ta kryejnë detyrën 1, në faqen 25 të librit bazë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 15-16.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

**ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Këngë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I-1, 6; VI-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.1; 4.2.

**ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Kur hyna n’portë t’kalasë

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Respekton rregullat e këndimit të drejtë;
  - Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, tabela, pianoja/sintisajzeri.



**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS**



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja vendos në qendër të tabelës (projektorit) fjalën “Kalaja” dhe kërkon nga nxënësit të shkruajnë ato që dinë për të.





**"Kur hyna n'portë t'kalasë"**

Intro 2+3



- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?

27



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;
Leximi dhe analiza e vargjeve;
Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësve;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që këngën ta këndojnë drejt (saktë), me frymëmarrje të duhur dhe artikullim të qartë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 17.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## Mësimi 10

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Elementet e formave muzikore

#### Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon elementet e formës muzikore në veprat që performojnë dhe dëgjojnë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; II-1, 6, 7, III-6, IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 3.2.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Elementet muzikore

#### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Gjen temën, fjalinë muzikore dhe periudhën muzikore në partiturë;
- Dallon elementet muzikore gjatë dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, partitura.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënësit**

Mësimdhënësi/ja lëshon pjesën “Për Elizën” e Bethovenit. Pasi ta kenë dëgjuar, nxënësit pyeten:  
- Çfarë vini re?

Njësia 10

### Elemente muzikore



Dëgjojmë

Dëgjeni pjesën “Per Elizën” të Bethovenit. Çfarë vini re?



Çelësat e mëimit

temë periudhë muzikore fjali muzikore

Me veprën e tij, çdo krijues hyn në marrëdhënie me njerëzit. Këtë marrëdhënie, ai e realizon nëpërmjet komunikimit apo nëpërmjet gjuhës me të cilën i drejtohet publikut.

Sic e dimë tashmë, edhe muzika ka gjuhën e saj. Me disa nga veçoritë e kësaj gjuhe do të njihemi në vijim.

#### Tema

Tema është një mendim muzikor që shprehet nëpërmjet një fjalie melodike. Zakonisht ajo ndodhet në fillim të veprës muzikore, duke u dalluar për individualitetin, të qëndruarit më vete. Tema muzikore luhet me një ose me shumë zëra.



Masat e ndërtimit të temave paraqiten të ndryshme në veprat muzikore. Ato shtrihen nga 8 deri në 16 masa.

Tema muzikore (ose melodija) është elementi kryesor mbi të cilin ndërtohen format e ndryshme muzikore. Nëpërmjet identifikimit të përsëritjes së temës ose kombinimit të saj, bëhet i mundur klasifikimi i formave muzikore.

#### Fjalja muzikore

Pjesët kryesore të periudhës, që në shumicën e rasteve janë dy, quhen fjali muzikore. Secila prej tyre paraqet në vetvete një ndërtim muzikor, masat e të cilit mund të jenë 4 deri në 8 (rrallë 16), që janë të ngjashme në pikëpamjen melodike.

#### Periudha muzikore

Një melodi e përbërë nga dy ose më shumë fjali muzikore quhet periudhë muzikore. Struktura e saj bën që mendimi muzikor që të jetë i qartë, i individualizuar, të mbahet mend mirë e të kapet shpejt nga dëgjuesit.

Kur periudha përbëhet nga dy fjali muzikore, quhet dy pjesëshe. Ajo mund të përbëhet edhe nga tri fjali muzikore. Në këtë rast, quhet periudhë muzikore tri pjesëshe.

32

Për shembull, te pjesa “Për Elizën” e Beethovenit, melodia kryesore përbëhet prej tetë masash dhe i korrespondon një periudhe muzikore.

Kjo periudhë është e përbërë nga dy fjali muzikore me nga katër masa, të cilat fillojnë me të njëjtin fragment melodik. Në këtë rast, periudha muzikore është dyfisheshe.

Fjalja a

Fjalja a'

Në këngën “Blowing in the wind” të Bob Dilanit, melodia kryesore përbëhet prej 24 masash dhe i korrespondon një “periudhe muzikore”. Kjo periudhë është e përbërë prej tri fjalish me nga tetë masa. Në këtë rast, periudha muzikore është trifisheshe.

Fjalja a

Fjalja a'

Fjalja a

**Detyrë**

► Evidentoni fjalitë muzikore të periudhës së mëposhtme. Përcaktoni sa pjesëshe është periudha.



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

Mësimi ndahet në dy paragrafë.

Lexohet paragrafi i parë (Tema, Fjalja muzikore) dhe, më pas, nxënësit së bashku me mësimdhënësin e komentojnë këtë paragraf.

Në të njëjtën mënyrë vepohet edhe me paragrafin e dytë (Periudha muzikore).

Më pas, mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e analizojnë këngën “Blowing in the wind”, duke bërë dallimin e periudhës muzikore, fjalive muzikore dhe masave.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit**

Nxënësit kryejnë detyrën në faqen 33 të librit bazë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësim i vazhdueshëm.

**Detyrë:**

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 25-26.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Gjinitë (llojet) muzikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Analizon muzikën vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe muzikën skenike, përmes shembujve muzikorë nga krijimtaria muzikore botërore dhe kombëtare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; II-1, 6, 7, III-6, IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.1; 3.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kantata dhe oratorioja

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Krahason Kantatën me Oratorion;
- Dallon Kantatën nga Oratorioja, përmes dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, Fletorja e punës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shkencat e natyrës.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

 **Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Nxënësit dëgjojnë fragmente nga “Kantata për Kongresin e Manastirit” e Fatos Lumanit dhe oratorioja “Juda Makabej” e Hendelit.

## Kantata dhe oratorioja



Dëgjoni “Kantatën për Kongresin e Manastirit” të Fatos Lumanit, kompozitorit shqiptar nga Maqedonia, krijimtaria e të cilit ka rëndësi të madhe edhe për historinë e muzikës shqiptare në Maqedoni.

Kantata dhe oratorioja janë forma muzikore vokalo-instrumentale, të cilat ekzekutohen nga orkestra, kori dhe solistë. Këto forma muzikore lulëzuan në shekujt XVI-XVIII, periudhë në të cilën lulëzoi edhe muzika korale.




### Kantata

Kantata është një formë muzikore vokalo-instrumentale, e cila ekzekutohet nga orkestra, kori dhe solistë. Në fillimet e saj, kantata ka qenë një formë vetëm vokale, ndryshe nga sonata që ishte menduar si formë instrumentale. Në rrjedhë të viteve, kantatës iu shtuan instrumentet shoqëruese, ariet, formacioni i harqeve dhe koratet.

Kompozitorët që kanë shkruar kantata janë të shumtë, por **Bahù** është një ndër mjeshtrit më përfaqësues të saj. Ai kompozoi rreth 300 kantata me tematikë fetare dhe laike. Mes kantatave laike të Bahut, dallohet “Kantata fshatare”, për të cilën ai shfrytëzoi meloditë e këngëve popullore gjermane. Kompozitorë të tjerë që shkruan kantata të të gjitha llojeve ishin edhe Hajdeni, Moxarti, Bethoveni, Shuberti, Berlioz, Stravinski dhe Briteni. Vlen të përmendet edhe kompozitorja franceze Elizabet Zhake de la Guer (Elisabeth Jacquet de la Guerre).

Këtë formë muzikore e kanë përdorur në krijimet e tyre edhe: Kristo Kono (kantatat “Malli për atdhe”, “Labëria”), Rexho Mulliqi (“Poema për ata”), Mark Kaçinari (kantatat “Bijtë e shqipes”, “Prishtinës heroike”), Gerti Druga (“Flas shqip”), Fatos Lumani (“Kantatë për Kongresin e Manastirit”) etj.



Kërkoni në internet informacion në lidhje me kantatën “Flas shqip” dhe prezantojeni atë në klasë.



Nga oratorioja "Juda Makabe HWV 63" e Hendelit, dëgjoni një korale.

### Oratorioja

Oratorioja është një formë muzikore vokalo-instrumentale, e cila ekzekutohet nga orkestra, kori dhe solisti. Ajo ngjan me operën për nga zhvillimi dhe karakteristikat e saj muzikore, vetëm se nuk shfaqet në skenë teatri dhe nuk përdoret kostumografia.

Fillesat e oratorios datojnë në shekullin XVI, kur feja vendosi të tërhiqte vëmendjen e njerëzve përmes vënies në skenë të tregimeve liturgjike. Megjithatë kompozitorë si Hajdeni dhe Rosini kanë shkruar oratorio, kompozitori më i madh i kësaj forme muzikore konsiderohet **Hendeli**. Ndër oratoriot e tij, shquhen: "Juda Makabe", "Samsoni", "Herkuli" dhe veçanërisht "Mesia".

Këtë formë muzikore e kanë përdorur në krijimet e tyre edhe: Tonin Harapi (oratorët "Fletë lavdie" dhe "Kënga e maleve"), Zeqirja Ballata ("Bir i vendit trimëror") etj.



► Nga oratorioja "Mesiah" e Xhorxh Fridrih Hendelit, dëgjoni pjesën e mirënjohur korale të mbylljes, "Hallelujah".

Kori që këndon këtë pjesë përbëhet nga:

- zëra të bardhë,
- zëra tenorësh dhe sopranosh,
- zëra sopranosh, altosh, tenorësh dhe basësh.

35



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Nxënësit ndahen në dy grupe të mëdha. Udhëzohet secili grup të lexojë pjesën e caktuar. Disa anëtarë të grupit do të shpjegojnë pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja, duke u bazuar në këto pyetje.

#### Grupi I: Kantata

- Çfarë është kantata? Nga kush ekzekutohet kantata? Cili ishte kompozitori që ka shkruar më së shumti kantata? Sa kantata i kompozoi Bahu dhe çfarë tematika kishin ato? Cilët ishin kompozitorët e tjerë që shkruan kantata? Përmend disa kantata të shkruara nga kompozitorët shqiptarë.

#### Grupi II: Oratorio

- Çfarë është oratorioja? Nga kush ekzekutohet oratorioja? Me cilën formë muzikore ngjan oratorioja? Kur datojnë fillesat e oratorios? Përmend disa kompozitorë që shquhen për këtë formë muzikore? Përse Hendel-i konsiderohet si kompozitori më i madh i kësaj forme muzikore? Cilat janë oratoriot më të shquara të Hendel-it? Përmend disa oratorio të kompozitorëve shqiptarë.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që të plotësojnë fletoren e punës në faqen 19.

#### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 20.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Gjinitë (llojet) muzikore

### Rezultatet e të nxënit të temës:

Analizon muzikën vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe muzikën skenike, përmes shembujve muzikorë nga krijimtaria muzikore botërore dhe kombëtare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 5; II-1; III-6; IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 3.1; 3.3; 4.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Simfonia dhe analiza e saj

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon simfoninë përmes dëgjimit;
- Analizon kohët e simfonisë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, partiturë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



### Parashikimi:

#### Përgatitja për të nxënë

Mësimdhënësi/ja lëshon kohën e parë “Allegro con brio”, të shkëputur nga “Simfonia në Do-, nr.5, op. 67” e Bethovenit. Pasi ta kenë dëgjuar, nxënësit pyeten:

- *A e kishit dëgjuar më parë atë?*
- *Çfarë ndjesish përcollti te ju?*

Përmes këtyre dy pyetjeve, bëhet e ditur njësia mësimore që do të zhvillohet.

## Simfonia dhe analiza e saj



### Dëgjojmë

Dëgjoni kohën e parë “Allegro con brio”, të shkëputur nga “Simfonia në Do-, nr. 5, op. 67” e Bethovenit. A e kishit dëgjuar më parë atë? Çfarë ndjesish përcollti te ju?

### Simfonia

Simfonia është kompozimi më i përpunuar dhe më i rëndësishëm në fushën e muzikës orkestrale. Termi *simfoni* rrjedh nga fjala greke *symphonia* që do të thotë të luajmë së bashku.

Simfonia filloi të njihet në shekullin XVIII dhe, njëherazi, falë kompozitorit italian Samartini dhe shkollës gjermane të Manhejmit, ajo u strukturua në mënyrë më të plotë. Pikërisht në këtë shkollë, brenda saj u përshtat forma e sonatës dhe ndarja në katër kohë.

Kohët e simfonisë ndryshojnë nga njëra-tjetra për sa i përket kohës dhe karakterit.

I	II	III	IV
ALLEGRO	ANDANTE	ALLEGRETTO	ALLEGRO
në formën e sonatës	romancë ose temë me varacion	minuet ose scherco	rondo ose në formën sonatës

Simfonia klasike kaq e mirëstrukturuar pati mjeshtrit e saj më të mëdhenj, si: Hajdenin, Moxartin dhe Bethovenin.

Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, kompozitorët iu shmangën shpesh skemës klasike.



► Pikturë e Max Oppenheimer-it (1925)  
Gustav Mahleri duke dirigjuar Orkestrën Filharmonike të Vjenës

### Analizojmë

#### Dëgjojmë së bashku:

Simfoni në g-mol nr. 40, K 550

Koha e parë, *molto allegro*

Kompozitor: Wolfgang Amadus Mozart

Koha e parë është shkruar në formën e sonatës. Ajo hapet vetëm me harqet të cilat luajnë *piano* temën e parë, një motiv që shpreh gjendje të trazuar emocionale. Tema e dytë (0:56) është më pak e rëndësishme se tema e parë dhe shpreh një gjendje më pak të trazuar emocionale. Ajo bazohet në dialogun mes harqeve dhe instrumenteve frymore të drunjtja.

Në pjesën e zhvillimit (3:47) lartësohen karakteristikat dramatike të temës së parë, duke theksuar kontrastet dinamike.

Në pjesën e reprizës (4:57) paraqiten sërish tema e parë (edhe më melankolike) dhe tema e dytë.

Në fund të kohës së parë, e gjithë orkestra luan *forte* një kodë shumë të vendosur dhe dramatike.

**kodë** - pjesa e fundit me të cilën mbyllet një pjesë muzikore.



### Detyrë

► 1. Si do ta përcaktonte kohën e parë të kësaj simfonie?

- |                                       |                                      |   |
|---------------------------------------|--------------------------------------|---|
| <input type="checkbox"/> Të gëzueshme | <input type="checkbox"/> Të qetë     | <input type="checkbox"/> Që të lë pa frymë      |
| <input type="checkbox"/> Dramatike    | <input type="checkbox"/> Shqetësuese | <input type="checkbox"/> Që të bën të ëndërrosh |

► 2. Si fillon pjesa?

- |  |  |
|--|--|
| <input type="checkbox"/> Me instrumentet frymore dhe harqet                  | <input type="checkbox"/> Me instrumentet frymore të cilat luajnë <i>piano</i> temën e parë |
| <input type="checkbox"/> Me harqet të cilat luajnë <i>piano</i> temën e parë | <input type="checkbox"/> Me harqet të cilat luajnë <i>forte</i>                            |

► 3. Si mbyllet pjesa?

- |  |  |
|--|--|
| <input type="checkbox"/> Me <i>diminuendo</i>  | <input type="checkbox"/> Vetëm me harqet           |
| <input type="checkbox"/> Në mënyrë të vendosur | <input type="checkbox"/> Duke luajtur <i>forte</i> |

37



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Fillimisht, mësimdhënësi do të jetë drejtues i diskutimeve dhe i sqarimeve për Simfoninë, ku gjatë kësaj periudhe ai jep informacione të rëndësishme. Pastaj, rolin e mësimdhënësit e merr nxënësi, i cili e sqaron përmbajtjen e mësimin nga ajo që ka dëgjuar nga mësimdhënësi. Nxënësi, gjithashtu, formulon pyetje të ndryshme, të cilave do t'u përgjigjen nxënësit e tjerë. Diskutimet dhe sqarimet vazhdojnë derisa përmbajtja të përvetësohet mirë. Por, sa herë që do të ketë nevojë për të asistuar, mësimdhënësi do t'i ndihmojë nxënësit. Mësimdhënësi lëshon edhe një herë në audio për dëgjim "Allegro con brio" e kompozitorit Bethoven. Gjatë kësaj kohe diskutohet rreth kohëve të simfonisë dhe karakterit të secilës kohë.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Mësimdhënësi/ja lëshon për ta dëgjuar "Simfoni në G-Mol nr. 40, K 550" e V. A. Mozart dhe, më pas, kërkon nga nxënësit që të kryejnë detyrën në librin bazë, në faqen 45.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 28-29.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 13

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Elementet muzikore

#### Rezultatet e të nxënit të temës:

Përdor elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit.

#### Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:

I-1, 5; II-1; III-5, 6, 7; IV-1, V-6.

#### Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

1.1; 2.1; 4.1; 4.3.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ritmi i përzier 7/8

#### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Demonstron ritmin 7/8;
- Dallon ritmin 7/8 gjatë dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**

Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



#### Parashikimi:

#### Përgatitja për të nxënësit

Mësimdhënësi/ja e lëshon këngën “Luleborë”, interpretuar nga Marigona Qerkezi dhe Merita Juniku. Pasi ta kenë dëgjuar atë, pyeten nxënësit:

- *Cfarë mund të thoni për ritmin e saj?*

Pas përgjigjeve të dhëna, arrihet te njësia mësimore që do të zhvillohet.

Njësia 13

### Ritmi i përzier 7/8



#### Dëgjojmë

Dëgjoni këngën “Luleborë”, të interpretuar nga Marigona Qerkezi dhe Merita Juniku. Cfarë mund të thoni për ritmin e saj?



#### Çelësat e mësimit




ritëm i përzier  
ritëm 7/8  
fleks

Në ritmet e përziera bën pjesë edhe ritmi 7/8, i cili, ashtu si ritmi 5/8, haset shpesh në muzikën tonë popullore.

#### Ritmi 7/8

Ritmi i përzier 7/8 paraqitet me dy lëvizje simetrike dhe me një lëvizje josimetrike me to.

Ky ritëm formohet nga bashkimi i dy masave muzikore 2/8 dhe i një mase 3/8: 2/8 + 2/8 + 3/8. Nga mënyra e paraqitjes, ai është si ritmi 3/4, me ndryshimin që ritmi 3/4 përbëhet nga tri lëvizje të barabarta, ndërsa ritmi 7/8 përbëhet nga dy lëvizje të barabarta dhe një lëvizje më e gjatë se të tjerat. Lëvizja më e gjatë është ajo që përmban tri notat tetëshe.



38



Nga mënyra se si ndahet në lëvizje, ky ritëm paraqitet në tri variante.

**Varianti I**  
 $\frac{3}{8} + \frac{2}{8} + \frac{2}{8} = \frac{7}{8}$

**Varianti II**  
 $\frac{2}{8} + \frac{3}{8} + \frac{2}{8} = \frac{7}{8}$

**Varianti III**  
 $\frac{2}{8} + \frac{2}{8} + \frac{3}{8} = \frac{7}{8}$

Në skemat e mësipërme, theksi i fortë bie në lëvizjen e parë, ndërsa theksi i butë bie në lëvizjen e dytë dhe të tretë.

**Detyrë**

► Lexoni ushtrimin ritmik në kohën 7/8. Shoqërojeni ushtrimin me lëvizje dore ose me instrument.

► Këndoni ose luani në instrument ushtrimin melodik në kohën 7/8.

DO RE MI FA SOL LA SI DO

39



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Po vijë' krushqit ma - le - ve... Ma - le - ve... Ju - sha...  
 ve... Gzon - ju a gzon - ju a ju krushq' a... se sot po merr si  
 ma - sen... a Gzon - ju... gzon - ju a ju krushq' a... se sot po  
 merr - si... ma - sen... a

1. Nxënësit ndahen në dy grupe: njëri grup e këndon këngën, kurse tjetri e shënon metrin e saj, apo mund të fillojë edhe ligjërimin ritmik të vargjeve të këngës me figurën ritmike 3+2+2. E gjithë kjo procedurë kryhet me ndihmën e mësimdhënësit/es.

2. Interpretimi shoqërohet me lëvizjet e dorës poshtë-djathtas-lart. Kjo mund të konkretizohet edhe me shigjeta nën vargje, të cilat shënohen në tabelë nga mësimdhënësi/ja.

Më pas, arrihet në përfundim se rrokjet në lëvizjet poshtë janë më të gjata, ndërsa dy lëvizjet e tjera më të shkurtra.

Në fund, rrokjet zëvendësohen me nota përkatëse dhe vihet në përfundim se kënga është në masën 7/8.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Kërkohet nga nxënësit që të kryejnë detyrën 1, në faqen 37 të librit bazë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 21-22.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Këngë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kur këndoj për ty moj nënë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Respekton rregullat e këndimit të drejtë;
- Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, tabela, pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Jeta dhe puna.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja shënon në tabelë thënien e mëposhtme pa renditje të rregullt, ku, më pas, kërkon nga nxënësit që, duke i përdorur saktësisht ato fjalë, të ndërtojnë një fjali.

Thënia që duhet ndërtuar është: “Gjithçka që jam apo që shpresoj të jem, ia kam borgj nënës sime engjëllore”.

### “Kur këndoj për ty moj nënë”

“Kur këndoj për ty moj nënë”, me muzikë nga Avni Mula dhe tekst nga Skënder Tapia, është një nga këngët më të njohura shqipe, kushtuar nënës. Kjo këngë është interpretuar për herë të parë në vitin 1978.

#### “Kur këndoj për ty moj nënë”



**I**  
 S'ka në botë më të mirë,  
 se sa ti moj nëna ime,  
 sa e dashur, sa e d'lrë,  
 sa punëtore, e sa trimë.  
 Je e mënçur, je e drejtë  
 dhe nga goja nxjerr veç mjalë.  
 Kënga jote rrjedh nga zemra,  
 sytë e tu ç'vështrim të zjarrtë.

**Refreni**  
 Ti je det, o det i gjerë,  
 plot me ndjenja, ëndërrime,  
 dashurinë për atdhe,  
 ma rrinjose nëna ime.

**II**  
 Dashurinë për atdhe,  
 për atdheun tonë të shtrenjët,  
 ma skaltë thellë në zemër,  
 se je nënë e vërtetë.  
 Ndaj të dua si vetë jetën,  
 kur të shoh ty të gëzuar.  
 Kur këndoj për ty moj nënë,  
 për gjithë nënat kam kënduar.

**"Kur këndoj për ty moj nënë"**

*Muzika: Avni Mula  
Teksti: Skënder Tapia*

*(Intro)*  
Ska në bo - të më të mirë

*Canto 1*  
se sa ti moj në - na i - me Sa e da - shur sa e di - re sa punë to - re

*Canto 2*  
dhe sa tri me - Je e men - çur je e drejtë dhe nga go - ja

*Kori*  
nxjerr vëçnjaltë kë - nga jo - te rrjedh nga ze - mra syt' e tu ç'vë - shtrim të zja - rrë -

Ti je det o det i gjërë plot me ndje - nja ë - në -

rrime da - hu - ri - në për at - dhe ma rrë - njo - senë - na i - me

*D.S.*

- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?

41



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;
Leximi dhe analiza e vargjeve;
Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësve;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që këngën ta këndojnë saktë, bukur, me frymëmarrje të duhur dhe artikulum të qartë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 23-24.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## Mësimi 15

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV      **Klasa:** VIII

**Tema:** Tonalitetet

#### Rezultatet e të nxënit të temës:

Një parimin e tonaliteteve të ndryshme muzikore dhe simbolet e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; II-1; III-6; IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shkalla F-Dur

#### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan shkallën F-Dur;
- Këndon shkallën F-Dur.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, tabela (pentagrami), pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të këndojnë shkallën Sol-maxhore/G-Dur, me përcjellje të sintisajzerit/pianos nga mësimdhënësi.

Pyeten nxënësit:

- Përse shkalla që kënduam titullohet G-Dur ?
- Si mendoni që do të quhej një shkallë e cila fillon me F dhe mbaron me F?

Njësia 15

### Shkalla F-dur

#### Kujtojmë

- Shkallë muzikore quhet *renditja graduale* ose *shkallëzuar* dhe *njëpasnjëshe* e tetë tingujve muzikorë, si në ngjitje, ashtu edhe në zbritje. Në çdo shkallë muzikore tingujt quhen *gradë*. Gradët i shënojmë me shifra romake.
- Shenja e shartimit diezis (#) e ngre notën me gjysmë toni, ndërsa shenja e shartimit bemol (b) e ul notën me gjysmë toni.

#### Shkalla F-dur

Shkalla *F-dur* ose shkalla *Fa Maxhore* është e ndërtuar nga pesë tone dhe dy gjysmëtone. Tonet ndodhen midis gradëve I-II, II-III, IV-V, V-VI, VI-VII. Gjysmëtonet ndodhen midis gradëve III-IV dhe VII-VIII.

Shkalla *F-dur* ka shenjë shartimi, e cila është *bemoli* (b). Për të formuar gjysmëtonin ndërmjet gradëve III dhe IV, përdorim këtë shenjë shartimi para notës Si.

Kjo është edhe shkalla e parë me një bemol në armaturë.



Shkalla *F-dur* gjendet duke zbritur pesë nota ose 3 tone e gjysmë nga nota *Do*.



#### Arpezi dhe akordi


Arpezi dhe akordi ndërtohen mbi gradët: I, III, V, VIII. Tingëllimi i njëpasnjëshëm i gradëve kryesore të vendosura njëra pas tjetres quhet *arpezh*. Bashkëtingëllimi i gradëve kryesore të vendosura njëra pas tjetres quhet *akord*. Ai shkruhet në mënyrë vertikale.



42


**Punojmë së bashku**

- Luani në instrument ushtrimet melodike në shkallën *F-dur*.



**Detyrë**

- Krijoni një ushtrim melodik në kohën 2/4, me tetë masa muzikore, në shkallën *F-dur*.




43



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

Jepet informacioni se këngët apo veprat e ndryshme muzikore mund të ndërtohen nga secili ton, dhe kështu fillon njësia *Shkalla F-dur*.

Mësimdhënësi/ja, me ndihmën e nxënësve, fillon në tabelë (pentagram), shënimin e shkallës F-Dur (notat, gradët). Plotësimi i shkallës me tone dhe gjysmëtone, shënohet me ndihmën e mësimdhënësit/es (me gradën IV të shkruar si “si”).



Më pas, mësimdhënësi/ja vendos në tabelë testaturën e pianos, dhe kërkon nga nxënësit të analizojnë përputhshmërinë e rregullit për tonet dhe gjysmëtonet. Kështu, paraqitet nevoja që grada IV nga “si” të zbritet në **si bemol**.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit**

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që në mënyrë individuale të punojnë detyrën e dhënë në librin bazë, në faqen 41.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësim i vazhdueshëm.

**Detyrë:**

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 25-26.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## Mësimi 16

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Ngjarje muzikore

#### Rezultatet e të nxënit të temës:

Shprehet për veprën e dëgjuar muzikore me vizatim, ese, poezi ose forma të tjera shprehëse artistike.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, II-3, III-5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 2.1; 2.2; 2.4.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Frymëzohemi nga artet e tjera

#### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Ndërlidh muzikën me pikturën;
- Frymëzohet nga artet e tjera.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja ua lëshon nxënësve për ta dëgjuar “Pikturat e një ekspozite”, e M. P. Musorgskit.

Njësia 16

### Frymëzohemi nga artet e tjera



Dëgjojmë

Dëgjoni “Pikturat e një ekspozite” të M. P. Musorgskit, kompozitorit rus që u frymëzua nga një ekspozitë e piktorit Viktor Hartman për shkrimin e kësaj pjesë.

Shpeshherë artistët dhe krijuesit e një fushe janë frymëzuar nga veprat e artistëve dhe të krijuesve të një fushe tjetër. Kështu, për shembull, kompozitori francez i shekullit XIX, Klod Debussy (Claude Debussy) frymëzohet nga pikturat impresioniste, me nuanca të lehta ngjyrash, por frymëzohet edhe nga eleganca e muzikës së periudhës së Barokut, si dhe nga poezia.

Vepra “Sytë bergameske” (*Suite bergamasque*) e këtij kompozitori është një përmbledhje prej katër pjesësh për piano, titulli i së cilës rrjedh nga poezia e Pol Verlenit (Paul Verlaine), dhe përfshin edhe pjesën e mirënjohur “Drita e hënës” (*Clair de lune*), e cila është frymëzuar po nga poezia e Verlenit.



A e dini se

Pjesa “Drita e hënës” është përfshirë në shumë kolona zanore filmash. *Twilight* është një nga filmat e mirënjohur në të cilët dëgjohet “Drita e hënës” e Debussyt.



#### Nga piktura në muzikë

Piktura e mëposhtme, e titulluar “Vazhdimësi” (1935), është realizuar nga piktori rus Vasilii Kandinski, një pararendës i pikturës abstrakte. Duke ndjekur udhëzimet vijuese, krijoni një melodi që e përfaqëson atë.



44

**Punë në grupe**

- Ndahuni në pesë grupe, aq sa janë pjesët e kësaj pikturë.
- Bëni analizën e pikturës, duke nxjerrë në pah karakteristikat e vijave, formave, ngjyrave, ritmit (rregullsisë ose rendit rastësor të përsëritjes së figurave apo shenjave) dhe të lëvizjes (statike dhe dinamike).
- Mendoni të bëni lidhjet mes elementeve të pikturës me muzikën (tinguj dhe ngjyra, tinguj dhe vija, tinguj dhe forma).
- Mendoni se si do të jetë melodia e grupit tuaj, por bini dakord me grupet e tjera për ritmin, shpejtësinë dhe pushimet.

Punë të mbarë!



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

Nxënësit ndahen në pesë grupe. Secilit grup do t'i shkëputet nga një pjesë nga piktura “Vazhdimësi”.

Grupet duhet të punojnë detyrën në faqen 43, si dhe të bashkëpunojnë në mes vete për ritmin, shpejtësinë dhe pushimet.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit**

Në fund të orës bëhet prezantimi i punimeve të secilit grup.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësim i vazhdueshëm.

**Detyrë:**

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 27.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Instrumentet dhe formacionet muzikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Analizon karakteristikat tingëllore dhe funksionale të instrumenteve të ndryshme muzikore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Njohim disa instrumente muzikore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon timbrin e instrumenteve gjatë dëgjimit;
- Dallon instrumentet aerofone (të drunjta nga ato të tunxhit, përmes dëgjimit.)

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, foto instrumentesh.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja lëshon për ta dëgjuar kohën e parë të “Simfonisë në g-mol, nr. 40, K550”, e Wolfgang Amadeus Moxartit dhe, më pas, i pyet nxënësit:

- Cilat janë instrumentet që arrini t’i dalloni?

Pas përgjigjeve të dhëna, u bëhet e ditur njësia mësimore që do të zhvillohet.

Njohim disa instrumente muzikore



Dëgjojmë

Dëgjoni kohën e parë të “Simfonisë në g-mol, nr. 40, K550” të Wolfgang Amadeus Moxartit. Cilat janë instrumentet që arrini të dalloni?

■ **Violina** është një instrument muzikor me tela, që klasifikohet në grupin e instrumenteve **kordofone**. Trupi i saj zakonisht është prej druri.

Violinat e para janë shfaqur në Italinë e shekullit XVI. Gjatë shekujve XVIII-XIX, ato pësuan modifikime, si rezultat i të cilave instrumenti prodhoi një tingull më të fuqishëm.

Violinat më të famshme janë bërë nga familjet: *Stradivari*, *Guarnieri* dhe *Amati*.



■ **Viola** është një instrument muzikor me tela, që klasifikohet në grupin e instrumenteve **kordofone**. Ajo ndryshon nga violina: së pari, është pak më e madhe se violina; së dyti, ka tingull më të ulët e më të thellë; së treti, ka tjetër celës muzikor, celësin Alto.


Përdorimi i violës është i nevojshëm si në muzikën orkestrale, edhe në atë të dhomës.

■ **Violonçeli** është një instrument muzikor me tela, i cili mbështetet në tokë mbi një bisht të posaçëm. Ai klasifikohet në grupin e instrumenteve **kordofone**. Përdoret si instrument muzikor solistik, si pjesë e formacioneve të muzikës së dhomës dhe si pjesë e orkestrave simfonike.

Tingulli i tij është më i ulët e më i thellë se ai i violës. Celësat me të cilët luhet janë celësat e Basit dhe të Tenorit, rallë edhe celësi i Solit.



■ **Kontrabasi**, së bashku me violinën, violën dhe violonçelin përbëjnë seksionin harkor të një orkestre ose harqet e saj. Ndër të gjitha këto instrumente, kontrabasi është më i madhi. Tingulli i tij është i ulët dhe kumbues. Ai prodhohet përmes tërheqjes së harkut ose pickimit të telave. Edhe kontrabasi është instrument **kordofon**.



Ne dhe interneti

Kontrabasi i shquar dhe kompozitori amerikan i muzikës afroamerikane, Çarls Mingus (Charles Mingus), interpreton solo në kontrabas pjesën *My jelly roll soul*. Kërkojeni në internet dhe vlerësoni interpretimin e tij.





■ **Flauti** bën pjesë në grupin e instrumenteve aerofone të drunjtja. Konsiderohet si "një instrument shumë i zhdërvjellët", për faktin se në të mund të luhet solo ose të jetë përgjegjës për mbajtjen e melodisë. Tingulli i tij konsiderohet i veçantë dhe shprehës.



■ **Klarineta** është një instrument që klasifikohet në grupin e instrumenteve aerofone të drunjtja. Një ndër veçoritë e saj është aftësia për t'u luajtur në registra të ndryshëm, çka e bën një zgjedhje ideale për një sërë zhanresh dhe stilesh muzikore. Falë kësaj aftësie, përveç muzikës klasike, me klarinetë mund të luhet edhe muzikë xhaz e suing.



■ **Tromba** është një instrument që klasifikohet në grupin e instrumenteve aerofone metalike. Tingujt e saj të ngrohtë e dallojnë atë nga instrumentet e tjera frymore (aerofone).



Instrumenti i trombës ka një vend të rëndësishëm në muzikën xhaz. Ai është simbol i kësaj muzike.



#### Ne dhe interneti



Tajn Thing Helseth (Tine Thing Helseth) është një trombiste shumë e njohur skandinave. Për të cmuar zotësinë e saj, kërkonti në internet interpretimin e saj të "Koncertit për trombë në Mi bemol" të Hajdenit, i cili me këtë kompozim i dha një shtysë përdorimit të këtij instrumenti si solist.

■ **Timpani** është një instrument që klasifikohet në grupin e instrumenteve membranofone. Ky instrument i prodhon tingujt nga dridhjet e lëkurës së tendosur. Luhet duke e goditur me shkopinj, të cilët quhen *shkopinj timpani*.



Timpani evoluoi në fund të shekullit XVIII, duke u bërë, kështu, një element kryesor i orkestrës klasike.

Sot timpanet përdoren në formacione të ndryshme, nga formacionet e koncerteve te formacionet marshuese, madje edhe në disa grupe rok.



#### Detyrë

- Dëgjoni "Suitën për flaut dhe piano", të kompozuar nga Valton Beqiri dhe të interpretuar nga Venera Mehmetaj-Kajtazi. Përshtuarani emocionet që ju dhuroi dëgjimi i kësaj pjese muzikore.



47



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Nxënësit ndahen në dy grupe. Udhëzohet secili grup të lexojë pjesën e caktuar. Disa anëtarë të grupit do të shpjegojnë pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja duke u bazuar në këto pyetje.

### Grupi I: Instrumentet kordofone

Përmend instrumentet kordofone. Si prodhohet tingulli në këto instrumente? Çfarë tingulli prodhon secili nga këto instrumente?

### Grupi II: Instrumentet aerofone dhe membranofone

Përmend instrumentet aerofone. Trego se në cilin grup të instrumenteve frymore hyjnë këto instrumente. Si prodhohet tingulli në këto instrumente? Kush bën pjesë në grupin e membranofoneve?



## Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit

Mësimdhënësi/ja lëshon në audio fragmente të interpretuara në instrumentet përkatëse. Gjatë kësaj kohe nxënësit duhet të mbajnë shënime për përcaktimin e instrumentit që dëgjojnë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 30.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Krijuesit dhe performuesit

**Rezultatet e të nxënës të temës:**  
 Njeh vepra dhe krijues të shquar të muzikës artistike kombëtare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.3; 4.1; 4.3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Interpretues të shquar

**Rezultatet e të nxënës të orës mësimore:**

- Njeh disa nga interpretuesit shqiptarë;
- Dallon zërat përmes dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**

Nxënësit dëgjojnë pjesë të kënduara nga gjashtë interpretuesit e mëposhtëm.

### Interpretues të shquar



Ramë Lahaj



Dëgjojmë

Dëgioni pjesën "O moj Arbëri", të interpretuar nga tenori Ramë Lahaj, i shoqëruar nga kori i fëmijëve "Okarina".

**Ramë Lahaj** (1983) lindi në Istog. Ai është një ndër tenorët kosovarë që ka interpretuar në teatrot më të mirënjohur të botës. Ndër rolet e tij më të spikatura, janë: Alfredo (opera "Traviata"), duka i Mantovës (opera "Rigoletto"), Rodolfo (opera "La Bohème") etj.

Ramë Lahaj ka marrë vlerësime të shumta, ku një ndër më të rëndësishmit është "Operalia". Ai është shpallur edhe *Ambasador Botëror i Kosovës*.



Besa Llugiqi



Dëgjojmë

Dëgioni pjesën "Vendi im", të interpretuar nga sopranoja Besa Llugiqi.

**Besa Llugiqi** (1986) u lind në Prishtinë. Ajo është fituese e shumë çmimeve në konkurse ndërkombëtare. Është angazhuar në teatro dhe festivale të ndryshme operistike brenda dhe jashtë vendit. Ndër rolet e saj, përmendim: Dona Elvira (opera "Don Xhovani"), Mimi (opera "La Bohème"), Violeta (opera "Traviata"), Liu (opera "Turandot"), Lucia (opera "Lucia di Lamermur") etj.



Marigona Qerkezi



Dëgjojmë

Dëgioni pjesën "Moj e bukura more", të interpretuar nga sopranoja Marigona Qerkezi.

**Marigona Qerkezi** (1993), sopranoja e talentuar kosovare, lindi në Zagreb. Koncertin e saj të parë si soliste vokale, e mbajti në Lubjanë në moshën 6-vjeçare. Është diplomuar për flaut, kanto dhe menaxhim biznesi. Spikat në rolin e Mbretëreshës së Natës ("Flauti magjik") dhe interpreton në teatrot më të mirënjohur në botë. Është shpallur fituese e shumë konkurseve edhe si flautiste, edhe si soprano.

### Dëgjime

Dëgjoni pjesën "Dhuratë për ditëlindje", të interpretuar nga sopranoja Inva Mula, e shoqëruar nga kori i fëmijëve.

■ **Inva Mula** (1963), sopranoja shqiptare me famë ndërkombëtare, lindi në Tiranë. Ajo ka bashkëpunuar me tenorë të famshëm në operën e Bastijës (Paris), në Bruksel, në Mynih dhe në Oslo. Ndër rolet e interpretuara prej saj, përmendim: Xhildën (opera "Rigoletto"), Rozinën (opera "Berberi i Sevijës"), Mimin (opera "La Bohème") etj. Është shumë e njohur për mënyrën e të kënduarit, gjë që e bëri shumë të famshme.



► Inva Mula

Inva Mula është fituese e çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare ("Këngëtarja Shqiptare", "George Enescu", "Butterfly", "Operalia"). Ajo është nderuar me urdhrin "Nderi i Kombit" dhe është pranuar si anëtare e Akademisë Botërore të Artit dhe të Shkencës.

### Dëgjime

Dëgjoni një arie nga "Ana Bolena" e Donizetti, të interpretuar nga sopranoja Ermonela Jaho.

■ **Ermonela Jaho** (1974), sopranoja shqiptare me famë botërore, lindi në Tiranë. Pas përfundimit të studimeve për këndim dhe piano, ajo fitoi disa konkurse të rëndësishme. Fillori të interpretonte në skenë në Bolonjë, në rolin e Mimit (opera "La Bohème"). Konsiderohet një nga ikonat e artit botëror, në role si: Suzana (opera "Dasma e Figaros"), Mikaela (opera "Karmen"), Norina (opera "Don Paskuale"), Liu (opera "Turandot"), Ana Bolena, Luiza (opera "Luiza Miller"), Cio-Cio-San (opera "Madamë Batërlaj") etj.



► Ermonela Jaho

### Dëgjime

Dëgjoni pjesën "Fjalët e qiririt", të interpretuar nga tenori Saimir Pirgu.

■ **Saimir Pirgu** (1981), tenori i shquar, lindi në Elbasan, ku në moshë shumë të re nisi mësimet e muzikës. Diplomoi për kanto në konservatorin "Klaudio Monteverdi" të Bolzanos (Itali).



► Saimir Pirgu

Është nderuar me çmime prestigjioze, si: "Pavaroti D'Oro", "Franco Corelli", "Caruso", "Tito Schipa" etj.

Repertori i tij i pasur përfshin rolet e Alfredos (opera "Traviata"), Rikardos ("Ballo me maska"), Hofmanit ("Përrallat e Hofmanit"), Romeos ("Romeo e Xhuljeta"), Rudolfo (opera "Luiza Miler"), Dukës së Mantovës (opera "Rigoletto") etj.

49



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Nxënësit, të udhëzuar nga mësimdhënësi/ja, do ta lexojnë mësimin të ndarë në katër paragrafë. Pas çdo paragrafi, do ta plotësojnë gradualisht tabelën e mëposhtme.

	Jeta	Rolet e interpretuara	Vlerësimet
Ramë Lahaj (tenor)	(1983)	Alfredo (Opera "Traviata") -Duka i Mantovës (Opera "Rigoletto") -Rodolfo (Opera "La Bohème")	-Çmimi "Operalia"
Besa Llugini			
Marigona Qerkezi			
Inva Mula			
Ermonela Jaho			
Saimir Pirgu			



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

Mësimdhënësi/ja lëshon përsëri në audio fragmente të kënduara nga gjashtë interpretuesit (jo sipas radhës). Nxënësit, gjatë kësaj kohe, duhet të mbajnë shënime për emrin e interpretuesit që dëgjojnë dhe përcaktimin e zërit të tij.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 31.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Kreativitet muzikor

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shprehet me lëvizje/vallëzim, shprehje letrare e figurative inspiruar nga muzika e dëgjuar.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 2; IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 4.2; 4.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vallet tona popullore

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon vallet tona popullore përmes dëgjimit;
- Rendit vallet tona popullore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.


**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, Fletorja e punës etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja vendos në qendër të tabelës fjalët “Vallet popullore” dhe kërkon nga nxënësit që të shkruajnë ato që dinë lidhur me të.



Vallet tona popullore

Vallet kanë lindur në periudha shumë të lashta, si pjesë përbërëse e botëkuptimit të njerëzve. Ato kanë qenë të lidhura me disa nga ritet që kishin të bënin me punët e përditshme, stinët, dasmat etj.

Veçoritë e valleve tona

Vallet e popullit tonë janë të shumta dhe të ndryshme. Ato interpretohen duke u shoqëruar ose jo me muzikë. Gjatë interpretimit të tyre, përfshihen të gjitha pjesët e trupit, pra këmbë, duar (gjestet), si dhe shprehje fytyre (mimika).



Ato kërcëhen nga burrat, nga gratë, nga burrat dhe gratë bashkërisht, si dhe nga fëmijët.

Vallet popullore dallojnë nga krahina në krahinë, nga vendi në vend. Ato shprehin tipare të ndryshme që i përkasin kulturës së popullit tonë, si: trimërinë, karakterin luftarak, forcën etj.

Vallet tona kanë koreografi të mirë-përcaktuara. Gjithsesi, gjatë interpretimit të tyre, ka rëndësi dhe improvizimi, që do të thotë liria e lëvizjeve, mimikës, e gjesteve, ashtu si mendon valltari a valltarja.

Vallja popullore plotësohet tërësisht kur interpretohet me kostumet popullore. Vetëm atëherë ajo i shpalos të gjitha vlerat e saj artistike.

Llojet e valleve

Në varësi të karakterit të tyre, vallet tona popullore ndahen në dy grupe të mëdha: *vallet lirike* dhe *vallet epike*.

Vallet lirike

Vallet lirike shprehin ndjenjat dhe emocionet për momentet më të bukura apo më të dhimbshme të jetës së njeriut. Ato kanë lindur nga përjetimet e situatat e ndryshme, si: punët bujqësore, dasma, dashuria etj. Ndër to, dallojmë:

- **Vallet e riteve të ndryshme** janë edhe vallet më të thjeshta, të cilat kanë në lëvizjet e tyre edhe imitimën e punëve të ndryshme. Për shembull, vallja e mbjelljes së grurit, vallja e shiut etj.

- Vallet e dasmave janë të lidhura me ritualin e dasmës, të cilat interpretohen në caste të caktuara të ceremonisë.
- Vallet e dashurisë interpretohen nga një grup valltarësh ose në dypse, si një dialog pa fjalë, i shprehur me anë të lëvizjeve koreografike. Ndër to përmendim vallen e Malësisë së Madhe, që quhet "Kërcim malësorësh", "Vallet e camë" të vajzave, "Vallet pogonishte" etj.



#### Vallet epike

Vallet epike janë të shumta. Ato interpretohen me krenari dhe madhësi, gjë që pasqyrohet edhe nga gjerësia e lëvizjeve. Vallet epike janë interpretuar kryesisht nga burrat. Këto valle kanë karakter luftarak dhe zakonisht janë të shoqëruara me surlle dhe tupanë.

Si më të veçantën, përmendim "Vallet luftarake", e cila kërcëhet edhe sot në Deçan dhe Rugovë. Ajo është një valle që interpretohet me shpata dhe pa shoqërim muzikor. Valle të tilla "të hesitura" janë shumë të pakta në botë.



#### Veprimtari

- ▶ Mësoni të kërceni një valle të njohur të zonës në të cilën banoni.
- ▶ Informohuni rreth aktiviteteve kulturore në të cilat marrin pjesë valltarë profesionistë. Organizohuni për të qenë të pranishëm në to.



#### Punojmë së bashku

- Mblidhni informacione rreth valleve popullore të zonës në të cilën banoni. Prezantoni ato në klasë.

55



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Në rubrikën DI nxënësit rendisin njohuritë që i dinë për vallet popullore.

Në rubrikën DUA TË DI nxënësit rendisin pyetjet lidhur me njohuritë që duan të dinë më shumë.

Në rubrikën MËSOVA renditen njohuritë e reja të mësuara në klasë.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Vallet tona popullore shprehin veçori që i përkasin popullit tonë.	Cilat janë llojet e valleve tona popullore?	



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënët

Nxënësit, të udhëzuar nga mësimdhënësi/ja, do të shkruajnë në mënyrë të pavarur nga një pesëvargësh për vallet popullore.

Vallet popullore

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 32-33.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Këngë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kur bien fyelli, çiftelia

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Respekton rregullat e këndimit të drejtë;
  - Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja e lëshon këngën “Kur bien fyelli, çiftelia”, interpretuar nga Vaçe Zela. Pasi ta kenë dëgjuar, pyeten nxënësit:

- *Cfarë ju bëri përshtypje gjatë dëgjimit të saj?*

Përmes kësaj pyetjeje, bëhet e ditur kënga që do të zhvillohet gjatë kësaj ore.

“Kur bien fyelli, çiftelia”



Dëgjoni këngën “Kur bien fyelli, çiftelia”, të interpretuar nga Vaçe Zela. Cfarë ju bëri përshtypje gjatë dëgjimit të saj?

Fyelli dhe çiftelia janë instrumente muzikore popullore, shumë të njohura dhe të përdorura edhe sot. Fyelli bën pjesë në instrumentet acrofone, kurse çiftelia në ato kordofone. Kjo këngë që mban në titull emrat e këtyre dy instrumenteve popullore, sjell motive baritore të malesisë sonë. Me tekst të Aleksandër Banushit dhe muzikë të Pjetër Gacit, kjo këngë është kënduar nga Vaçe Zela.

“Kur bien fyelli, çiftelia”

<p><b>I</b></p> <p><i>Kur bien fyelli, çiftelia, natën deri von, vet' nga zemra k'ndon malsia, krenaria jonë. Ti, o fyell' i harive, hukur po ting'llon nëpër bjeshtat e mal'sive që lavdin ndriçon</i></p>	<p><b>Refreni</b></p> <p><i>Bjери çifteli's, or djal' këng'e trimave ushton kur bien fyelli, çiftelia natën deri von' vet' nga zemra k'ndon mal'sia krenaria jon'.</i></p>	<p><b>II</b></p> <p><i>M'ushen malet me tarraca shkallë shkallë qëndis' do t'i kthejmë në tok' pjellore shkrepat e mal'sisë prandaj kanga dhe jehona maleve ushton sot po gëzohen zemrat tona g'zon malsia jonë.</i></p>
---	--	--



**"Kur bien fyelli, çiftelia"**

Teksti: Aleksandër Banushi  
Muzika: Pjetër Gaci

(Intro) Canto

Kur bien fy - e lli ç i - fte - li - a na - tën de - ri vonë

6  
vet' nga ze - mra k'ndon ma - lë - sia kre - na - ri - a jonë

7  
Ti - o fy - e lli i ba - ri - ve bu - kur - po - ting' - llon

9  
në - për ljeshtë e ma lë - si - ve që la - vdi n d r i - ç on

11  
Bje - ri ç i - fte - lis' or djal'

13  
Këng' e tri - ma - vo u - shton

15  
Kur bien fy e lli ç i - fte - li - a na - tën de - ri von'

17  
vet' nga zem - ra k'ndon ma - lë - sia kre - na - ri - a jonë

- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?



57



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;
Leximi dhe analiza e vargjeve;
Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësvë;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen që këngën ta këndojnë drejt, me frymëmarrje të duhur dhe artikulum të qartë.

### Vlerësimi i nxënësvë:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 34-35.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## Mësimi 21

### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Elementet muzikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

Përdor elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë këndimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 5; II-1; III-5, 6, 7; IV-1, V-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1.

### ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ritmi i përzier 9/8

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Demonstron ritmin 9/8;
- Dallon ritmin 9/8 gjatë dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, pianoja/sintisazjeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja e lëshon këngën "A kanë ujë ato burime." Pasi ta kenë dëgjuar atë, pyeten nxënësit:  
- Çfarë mund të thoni për ritmin e saj?

Pas përgjigjeve të dhëna, bëhet e njohur njësia mësimore që do të zhvillohet.

Njësia 21

### Ritmi i përzier 9/8



Dëgjajmë

Dëgjoni këngën "A kanë ujë ato burime".  
Çfarë mund të thoni për ritmin e saj?



Çelësat e mësimit

ritëm i përzier theks ritëm 9/8

Në ritmet e përziera bën pjesë edhe ritmi 9/8, i cili, ashtu si ritmet 5/8 dhe 7/8, haset në muzikën tonë popullore.







#### Ritmi 9/8

Ritmi i përzier 9/8 paraqitet me katër lëvizje josimetrike. Nga këto lëvizje, më e gjata është lëvizja që përmban tri notat tetëshe.

Ky ritëm formohet nga bashkimi i katër masave muzikore: nga tri masa 2/8 dhe nga një masë 3/8: 2/8 + 2/8 + 2/8 + 3/8.

Nga mënyra e paraqitjes, ai është si ritmi 4/4, me ndryshimin që ritmi 9/8 përbëhet nga tri lëvizje të barabarta dhe nga një lëvizje më e gjatë se të tjerat.



58



Nga mënyra se si ndahet në lëvizje, ky ritëm paraqitet në katër variante:

<p><b>Varianti I</b></p> $\frac{2}{8} + \frac{2}{8} + \frac{2}{8} + \frac{3}{8} = \frac{9}{8}$	<p><b>Varianti III</b></p> $\frac{2}{8} + \frac{3}{8} + \frac{2}{8} + \frac{2}{8} = \frac{9}{8}$
<p><b>Varianti II</b></p> $\frac{2}{8} + \frac{2}{8} + \frac{3}{8} + \frac{2}{8} = \frac{9}{8}$	<p><b>Varianti IV</b></p> $\frac{3}{8} + \frac{2}{8} + \frac{2}{8} + \frac{2}{8} = \frac{9}{8}$



**Detyrë**

Lexoni ushtrimin ritmik në kohën 9/8. Shoqërojeni ushtrimin me lëvizje dore ose me instrument.

59



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

1. Nxënësit ndahen në dy grupe: njëri grup e këndon këngën “A kanë ujë ato burime”, të dëgjuar më parë, kurse grupi tjetër e shënon metrin e saj, apo mund të fillojë edhe ligjërimin ritmik të vargjeve të këngës me figurën ritmike 2+2+2+3. E gjithë kjo procedurë kryhet me ndihmën e mësimdhënësit/es.
2. Interpretimi shoqërohet me lëvizjet e dorës poshtë-majtas-djathtas-lart. Kjo mund të konkretizohet edhe me shigjeta nën vargje, të cilat shënohen në tabelë nga mësimdhënësi/ja.

Më pas, arrihet në përfundim se rrokjet në lëvizjet lart janë më të gjata, ndërsa tri lëvizjet e tjera më të shkurtra.

Në fund, rrokjet zëvendësohen me nota përkatëse dhe vihet në përfundim se kënga është në masën 9/8.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit**

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të kryejnë detyrën në faqen 59 të librit bazë.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësim i vazhdueshëm.

**Detyrë:**

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 36-37.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Këngë

### Rezultatet e të nxënit të temës:

Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kur filloi drita me dalë

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Respekton rregullat e këndimit të drejtë;
- Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Nxënësit e dëgjojnë këngën “Kur filloi drita me dalë”, interpretuar nga Esat Bicurri, dhe, më pas, pyeten:

- Çfarë ju bëri përshtypje gjatë dëgjimit?

### “Kur filloi drita me dalë”



Dëgjojmë

Dëgjeni këngën “Kur filloi drita me dalë”, të interpretuar nga Esat Bicurri. Çfarë ju bëri përshtypje gjatë dëgjimit të saj?

“Kur filloi drita me dalë” është një nga këngët më të njohura të muzikës popullore, e interpretuar edhe nga i mirënjohuri Esat Bicurri, emrin e të cilit mban një cmim kombëtar që jepet për përsosuri në muzikë popullore dhe urbane.

### “Kur filloi drita me dalë”

<p><b>I</b></p> <p><i>Kur filloi drita me dalë hej aman Kur filloi drita me dalë hej aman Knojn' bilbilat nëpër pemë hajde mori aman Knojn' bilbilat nëpër pemë hajde mori aman.</i></p>	<p><b>II</b></p> <p><i>Kno bilbil ti qofsh i bardhë heej aman Kno bilbil ti qofsh i bardhë heej aman Ti na mbushe me gazmend hajde mori aman Ti na mbushe me gazmend hajde mori aman.</i></p>
<p><b>III</b></p> <p><i>Do të shoh që rri me lule heej aman Do të shoh që rri me lule heej aman Ajo knon këngën e vet hajde mori aman Ajo knon këngën e vet hajde mori aman.</i></p>	

**"Kur filloi drita me dalë"**

*Canto*

- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?



Esat Bicurri (1949-1999) ka qenë një këngëtar i mirënjohur gjakovar, pjesëmarrës në "Akorde e Kosovës" dhe fitues në gara të ndryshme muzikore. Ndër këngët e tij më të pëlqyera, përmendim: "E kujtoj atë takim", "Eja e bardha verë", "Një lulishte me trëndafila", "S'ka më të bukur se pranvera" etj. Ai është edhe autor i librave "Një këllëf me ar ta cova" dhe "Ahengjet gjakovare në shekuj". Ai u vra nga forcat paramilitare serbe në vitin 1999.

61



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;
Leximi dhe analiza e vargjeve;
Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësve;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që këngën ta këndojnë drejt (saktë), me frymëmarrje të duhur dhe artikulum të qartë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 38.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---



---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Tonalitetet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Njeh parimin e tonaliteteve të ndryshme muzikore dhe simbolet e tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; II-1; III-6; IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shkalla D-Mol

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan shkallën F-Dur;
- Këndon shkallën F-Dur.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, tabela (pentagrami), pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që ta këndojnë shkallën F-Dur, nën përcjellje të pianos/sintisajzerit nga ana e mësimdhënësit/es.

### Shkalla d-mol

**Kujtojmë**

Shkallët mol ose shkallët minore i shënojmë me “-” ose me “m” të vogël. Shkallët minore përcjellin ndjenjën e qetësisë dhe të melankolisë.

**Shkalla d-mol**

Cdo shkallë dur (maxhore) ka përkatësen e saj mol (minore). Po të zbrisim tri nota ose 1 ½ nga shkalla F-dur, gjejmë përkatësen e kësaj shkalle, që është shkalla d-mol ose re minore (Mi-). Shkalla d-mol fillon dhe mbaron me notën Re.



Sikundër mësuam, shkalla F-dur ka një shenjë bemol në notën Si. E njëjta gjë vlen edhe për përkatësen e saj, shkallën d-mol.

**Shkalla F-dur**

**Shkalla d-mol**

Shkalla d-mol ose shkalla re minore është e ndërtuar nga pesë tone dhe dy gjysmëtone. Tonet ndodhen midis gradëve I-II, II-III, IV-V, V-VI, VI-VII. Gjysmëtonet ndodhen midis gradëve: III-IV dhe VII-VIII.

Shkalla d-mol ruan shenjën e shartimit bemol në notën Si, ashtu si shkalla F-dur.

### Arpezi dhe akordi

Arpezi dhe akordi ndërtohen mbi gradët: I, III, V, VIII. Tingëllimi i njëpasnjëshëm i gradëve kryesore të vendosura njëra pas tjetrës quhet *arpezi*. Bashkëtingëllimi i gradëve kryesore të vendosura njëra pas tjetrës quhet *akord*. Ai shkruhet në mënyrë vertikale.



### Shkalla d-mol natyrore, harmonike dhe melodike

Shkalla d-mol është **natyrore** kur gjysmëtonet janë midis gradëve II-III (Mi-Fa) dhe V-VI (La-Si b).



Shkalla d-mol është **harmonike** kur gjysmëtonet janë midis gradëve II-III (Mi-Fa), V-VI (La-Si b) dhe VII-VIII (Do# - Re). Pra, veçori e shkallës d-mol harmonike është që grada VII është e ngritur.



Shkalla d-mol është **melodike** kur gjysmëtonet në ngjitje janë ndërmjet gradëve II-III (Mi-Fa) dhe VII-VIII (Do# - Re), ndërsa gjysmëtonet në zbritje janë ndërmjet gradëve VI-V (Si b-La) dhe III-II (Fa-Mi).



Detyrë

► Krijoni një ushtrim melodik në kohën 2/4, me tetë masa muzikore, në shkallën d-mol.



63



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Në vazhdim, paraqitet në tabelë vargu tonal si më poshtë:



Mësimdhënësi/ja i nxit nxënësit që të këndojnë vargun tonal nga F1-D2, e më pas bëhet kthimi gradual nga D2-D1.

Gjatë kësaj procedure mësimdhënësi/ja i ndihmon nxënësit, duke e përdorur shkopthin (duke “prekur” notat gjatë këndimit).

Kështu, arrihet në përfundim të shkallës së re që quhet shkalla D-Mol. Më pas, aktivizohen nxënësit që, përmes tastierës së pianos së paraqitur në tabelë, të emërtojnë tonet e shkallës, vendosjen e gradëve, si dhe radhitjen e re të toneve dhe gjysmëtoneve.



Po ashtu, mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të ndërtojnë arpezhin dhe akordin e shkallës D-Mol, e më pas, jep sqarime për të tria llojet e shkallës D-Mol (për tonet dhe gjysmëtonet).



### Përforsimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që të kryejnë detyrën në faqen 63 të librit.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 39-40.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Interpretim në instrumente

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shoqëron këngët dhe luan pjesë instrumentale, sipas imitimit ose me tekst notal, në zhanre të ndryshme, individualisht dhe në grupe.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Luajmë në instrument

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Interpreton saktë dhe drejt në blokflaut;
- Aplikon leximin parlatore në dy mënyra.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, blokflauta, pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shkencat e natyrës.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që t'i rikujtojnë rregullat e interpretimit në blokflaut.

### Luajmë në instrument



*Allegretto*



*Andante*



*Allegretto*



*Moderato*





*Allegretto*

*Moderato*

*Allegro*

65



**Ndërtimi i njohurive:  
Përpunimi i përmbajtjes**

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit lexojnë (parlato ritmik dhe solfezh-këndim) dhe, pastaj, bëhet luajtja në blokflaut e katër ushtrimeve në faqen 64. Interpretimi bëhet fillimisht në tempo më të ngadaltë, në fraza më të vogla dhe, në fund, tërë ushtrimi bëhet sipas tempos së përcaktuar.



**Përforcimi:  
Konsolidimi i të nxënit**

Nxënësit e klasës, në mënyrë të pavarur, luajnë në blokflaut tri ushtrimet në faqen 65.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësim i vazhdueshëm.

**Detyrë:**

Të ushtrojë në fletoren e punës, faqet 41-42.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet

**Lënda:** Edukatë muzikore

**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII

**Tema:** Ngjarje muzikore

### Rezultatet e të nxënit të temës:

Shprehet për karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin, përmbajtjen) me gojë, me shkrim, forma vizuale, prezantim me teknologji bashkëkohore, teknologjinë muzikore etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.2; 1.3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Muzika dhe loja

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Ndërlidh muzikën me lojën;
- Dallon ninullën përmes dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**

**Përgatitja për të nxënë**

Nxënësve u lëshohet kënga “Bersëzë, op. 27 (Berceuse, op. 27)”, e Frederik Shopenit.

## Muzika dhe loja



**Dëgjojmë**

Dëgjoni pjesën “Bersëzë, op. 27” (Berceuse, op. 27) të Frederik Shopenit, e cila krijon një efekt përkundës.

*Arrini t'i kujtoni meloditë e fëmijërisë suaj? Po ninullat që jua kanë kënduar?*

Para se të fillojnë të kuptojnë fjalët, fëmijët perceptojnë tinguj e zhurma dhe, duke u rritur, kalojnë te vjershat, te filmat vizatororë, te këngët për fëmijë, te gjëgjëzat etj., që përbëjnë shpesh materialin bazë të lojërave kolektive. Shumë prej “lojërave të fjalëve” janë kthyer në këngë për t'u luajtur.

### Ninulla: një “përkëdhelje melodike”

Kjo lojë këngë është e pranishme në të gjitha kulturat dhe në çdo vend të botës, pasi ka si qëllim vënie në gjumë të fëmijëve.

Ninulla përfaqëson për fëmijën kontaktin e parë me gjuhën dhe me muzikën.

Ninullat popullore janë përcjellë gojarisht nga brezi në brez dhe shprehin në formë të thjeshtë dhe të vetvetishme ide, ndjenja dhe probleme të përditshme.

Edhe në repertorin e shumë kompozitorëve, bëjnë pjesë ninullat, të cilat u përcjellin dëgjueseve emocione, përmes ekzekutimit të një instrumenti ose zërit të njeriut.



**Punë në grupe**

Me ndihmën e të afërmeve, kujtoni disa ninulla. Secili anëtar i grupit të përpiqet të mësojë njërin prej tyre në mënyrë që ta interpretojë. Pas interpretimeve të të gjithë anëtarëve të grupit, krahasoni ninullat që keni mbledhur, duke nxjerrë në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet mes tyre.





### Lojërat e shoqëruara nga kënga

Në rreth, në dyshe, në rresht, me top, me litar, lojërat e shoqëruara nga kënga bëjnë bashkë zbatimin, këngën, ritmin dhe lëvizjen. Ato janë pjesë e rritjes së fëmijëve të të gjitha kohëve dhe të të gjitha vendeve të botës.

Keto lloj këngësh i zbatimin fëmijët gjatë lojës dhe i ndihmojnë të shoqërohen me njëri-tjetrin.



### Muzika klasike e frymëzuar nga fëmijëria



Bota e fëmijëve u ka ofruar gjithnjë kompozitorëve mundësi të mëdha krijuese. Krahas repertorit të shkruar për t'u interpretuar nga fëmijët dhe të rinjtë, është edhe repertori i frymëzuar nga fëmijëria, i cili jo domosdoshmërisht dëgjohet apo interpretohet nga fëmijët.

#### Detyrë

- ▶ Dëgjoni "Lojëra fëmijësh, op. 22", të krijuar në vitin 1871 nga kompozitori francez Xhorxh Bize, e cila evokon lojëra dhe situata fëmijërore.
- ▶ Dëgjoni përmbledhjen "Dhoma e fëmijëve" të krijuar në vitin 1872 nga kompozitori rus Modest Musorgskij. Kjo përmbledhje përbëhet prej shtatë skenash të cilat evokojnë një fëmijëri plot energji, jetë, dashuri, por edhe plot me frikëra e brishtësi.
- ▶ Pas dëgjimit të pjesëve të sugjeruara, përgjigjuni me shkrim pyetjeve:
  - A kishin ndryshime apo ngjashmëri dy pjesët që dëgjuat?
  - Cila pjesë ju bëri më shumë përshtypje? Pse?
- ▶ Krahasoni përgjigjet tuaja me ato të shokëve dhe shoqeve të klasës.

67



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi ndahet në tre paragrafë. Mësimdhënësi/ ja i udhëzon nxënësit që të lexojnë paragrafin e parë "Ninulla: një përkëdhelje melodike" në mënyrë individuale dhe, më pas, një nxënës ta komentojë atë. Pasi të komentohet paragrafi i parë, lexohen edhe paragrafët e tjerë, si: "Lojërat e shoqëruara nga kënga" dhe "Muzika klasike e frymëzuar nga fëmijëria". Komentohet pas çdo paragrafi.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Lojë: Nxënësit ndahen në gjashtë grupe, me nga 3-4 nxënës në grup. Secili grup do të kryejë ushtrimin e dytë në fletoren e punës në faqen 43, duke e zhvilluar lojën sipas udhëzimeve të shënuara.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

T'i kryejë ushtrimet numër I dhe III në fletoren e punës, faqet 43-44.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Këngë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.1; 4.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Luleborë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Respekton rregullat e këndimit të drejtë;
- Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**

Mësimdhënësi/ja në tabelë paraqet një foto të luleborës dhe i nxit nxënësit që të diskutojnë për foton që shohin.

“Luleborë”



Dëgjoni këngën “Luleborë”, të interpretuar nga Inva Mula. Përkruani atmosferën që përcolli te ju kjo këngë.

Kënga “Luleborë” u shkrua në vitin 1946 nga poeti shkodran Zef Pali dhe u kompozua nga Simon Gjoni. Ajo është një këngë që i ka rezistuar kohës dhe prej shtatë dekadash këndohet e dëgjohet me endje.

Prej vitit 2016, mbahet *Festivali Luleborë*, i cili e ka marrë emrin prej kësaj kënge. Ruajtja dhe pasurimi me krijime të reja i trashëgimisë së këngës qytetare shkodrane, por edhe asaj mbarëshqiptare, përbën qëllimin kryesor të këtij festivali.

“Luleborë” është kënga e shpallur himn i muzikës lirike shqiptare. Ajo është kënduar nga Avni Mula, Dua Lipa, Inva Mula, Ramë Lahaj, Rosela Gjylbegu etj.

“Luleborë”

<p><b>I</b></p> <p><i>Tuj shëtitun mal e kodër,              tuj prek lulet gjithë me dor',              në një kopsht ma t'buk'rin n'Shkodër              ty të gjeta lulebor'.</i></p>	<p><b>II</b></p> <p><i>Pash' ma t'buk'rën stin' t'pranverës,              pash' ma t'buk'rin drandofill,              mos t'ia falish kujt ti erën,              se për mae vetëm ke çil'!</i></p>
<p><b>Refreni</b></p> <p><i>Je e vogël, por je plot',              ty t'kërkoj un' tash sa mot,              tash sa mot un' ty t'kërkoj,              n'g'zim me ty jetën ta çoj.              Eja, eja lulebor'              se me ty do t'thur kunor.</i></p>	



### "Luleborë"

Moderato

Muzika: Simon Gjoni

- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?



**Simon Gjoni** (1925–1991) është muzikanti që spikati që kur ishte i ri dhe kontribuoi si drejtues i shumë formacioneve orkestrale dhe vokale të qytetit të tij të lindjes, Shkodrës. Ka kompozuar një sërë këngësh të paharruara, si: "Fyelli i çobanit", "Sytë e tu si drita", "Nëna dhe çika" etj. Ndër kompozimet e tij, përmendim edhe odën lirike "Pranvera jonë" (me tekst të Ismail Kadaresë), "Poemën e rapsodit", baladën "Lufton shqipja" (kënduar nga basi Lukë Kaçaj), vallen e parë simfonike shqiptare, e cila do të pasohet nga dhjetë valle të tjera që paraqesin një gërshetim të muzikës së kultivuar me muzikën popullore.

Simon Gjoni ka qenë edhe dirigjent i orkestrave të para simfonike në "Radio Televizionin Shqiptar" dhe në "Teatrin e Operas dhe Baletit" në Tiranë. Ai ka dhënë një kontribut të çmuar edhe si mësimsdhënës, duke iu përkushtuar përgatitjes së dhjetëra studentëve.

69



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;
Leximi dhe analiza e vargjeve;
Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësve;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që këngën ta këndojnë drejt (saktë), me frymëmarrje të duhur dhe artikulum të qartë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 45-46.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Krijuesit dhe performuesit

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Njeh vepra dhe krijues të shquar të muzikës artistike kombëtare.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, IV-1.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 3.3; 4.1; 4.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Njohim kompozitorët tanë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Përshkruan jetën dhe veprën e disa kompozitorëve tanë;
- Dallon veprat e kompozitorëve tanë përmes dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, Fletorja e punës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja lëshon për të dëgjuar nga një fragment të veprave të rekomanduara në libër të kompozitorëve gjegjës.

Njohim kompozitorët tanë



Dëgjoni "Elegji për piano" të Mark Kaçinari.



▶ Mark Kaçinari

■ **Mark Kaçinari** (1935-1985) lindi në Prizren dhe i përket brezit të parë të studentëve shqiptarë nga Kosova, të cilët kanë kryer Akademinë e Muzikës. Ka qenë kompozitor, pedagog, dirigjent dhe hartues tekstesh shkollore.

Në vitin 1969 themeloi korin "Collegium Cantorum", me të cilin realizoi një numër të madh koncertesh. Për punën e palodhur pedagogjike, udhëheqëse e krijuese është shpërblyer me shumë diploma e mirënjohje, si dhe me "Medaljen Presidenciale të Meritave".

Ndër veprat më të njohura të tij, janë: "Bijtë e shqipes" (kantatë për kor miks a capella), "Zogu i Ohrit" (përpunim për kor miks), "Shamikuja" (suitë me motive popullore), "Drandofilla e vogël" (këngë popullore e përpunuar për kor), "Duart e vogla" (katër miniatura pianistike) etj.



Dëgjoni "Zambaku i Prizrenit" të Akil Kocit.



▶ Akil Koci

■ **Akil Koci** (1936) lindi në Prizren. Ai është shumë i njohur për kompozime të gjinive të ndryshme. Ka kompozuar muzikën për baletin "Sokoli dhe Mirusha" (1976), i cili është edhe baleti i parë shqiptar në Kosovë.

Është fitues i shumë çmimeve kombëtare e ndërkombëtare dhe është shpallur "Qytetar nderi" i Prishtinës (1974). Ndër veprat e tij korale, përmendim: "Lirisë", "Vajzës", "Nënës sime", "Kaltërirat" etj. Nga krijimtaria e tij për vokal e piano, veçojmë: "Popullit tim", "Elegji", "Trimja gjakovare" etj.



Dëgjoni "Gjashtë variacione në temë popullore" të Vincenc Gjinit.



▶ Vincenc Gjini

■ **Vincenc Gjini** (1935) lindi në Ferizaj. Ai u diplomua në Akademinë e Muzikës në Beograd për teori dhe pedagogji muzikore. Në Shkup, studioi dhe u diplomua për kompozim.

Vincenc Gjini ka krijuar një numër të konsiderueshëm veprash. Mes tyre: tri simfoni, simfonietta, dhjetë kantata, sonata për violinë e piano, variacione për klarinetë e piano etj.

### Dëgjime

Dëgjoni këngën "Me lule të bukura" të Tish Dajës.

■ **Tish Daija** (1926-2003) ka qenë kompozitor dhe muzikant i shquar. Që në moshë të vogël, u bë pjesë e korit të drejtuar nga Martin Gjoka. Mësimet e para i mori në vendlindje (Shkodër), bashkë me Tonin Harapin, Çesk Zadenë, Lukë Kacajn e Simon Gjonin.

Kompozimet e tij të para janë këngët: "Çik-o mori çikë", "Me lule të bukura", "Bjери gajdes gajdexhi" etj.

Është shquar për kontributin e madh në krijimin dhe zhvillimin e muzikës instrumentalo-simfonike, muzikës së dhomës, si dhe krijimin e një tradite të cmuar shqiptare të muzikës klasike.

Ndër veprat e tij, përmendim: operetën "Lejlaja", operën "Pranvera", baletin e parë shqiptar "Halili dhe Hajria" etj.



► Tish Daija

### Dëgjime

Dëgjoni "Uverturën festive" të Nikolla Zoraqit.

■ **Nikolla Zoraqi** (1929-1991) lindi në Tiranë. Ai është kompozitori shqiptar që dha një kontribut të veçantë në zhvillimin e muzikës së re shqiptare. Është autor i mjaft pjesëve për solist, kor e orkestrë, i shumë baladave, operave për fëmijë, koncerteve për violinë dhe orkestrë, baleteve, operave etj.

Nikolla Zoraqi është edhe krijues i veprave muzikore me karakter të theksuar kombëtar, ndër të cilat përmendim: "Komisari", "Shota e Azem Galica", "Cuca e maleve", "Gjorg Golemi" etj.



► Nikolla Zoraqi

### Dëgjime

Dëgjoni pjesën "Aura I" të Donika Rudit.

■ **Donika Rudi** (1982) ka lindur në Prishtinë. Ajo është kompozitore e muzikës elektroakustike dhe instrumentale. Është udhëheqëse e "Qendrës së Muzikës Elektronike – NOISE", si dhe drejtore artistike e Festivalit Ndërkombëtar të Muzikës së Re - ReMusica. Ka shkruar muzikë baleti kontemporan, muzikë dhome, korale, elektroakustike etj.

Kompozimet e saj janë interpretuar në Kosovë, Shqipëri, Francë, Zvicër, Itali etj.



► Donika Rudi

71



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Nxënësit, të udhëzuar nga mësimdhënësi, do ta lexojnë mësimin të ndarë në katër paragrafë. Pas çdo paragrafi, do ta plotësojnë gradualisht tabelën e mëposhtme.

	Jeta	Veprimtaria	Karakteristika
Mark Kaçinari	(1935-1985)	- "Bijtë e shqipes" - "Zogu i Ohrit" - "Shamikuqja" - "Drandofillja e vogël"	- Themeloi korin "Collegium Cantorum" - U shpërblye me "Medaljen Presidenciale të Meritave"
Akil Koci			
Vinçenc Gjini			
Tish Daija			
Nikolla Zoraqi			
Liburn Jupolli			



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit të ndarë në katër grupe udhëzohen nga mësimdhënësi/ja që të shkruajnë nga një pësëvargësh, ku secilit grup i jepet nga një personalitet. Më pas, lexohen nga përfaqësuesit e grupit.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 47.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Zhanret muzikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Dallojnë dhe krahasojnë veprat sipas zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, xhaz, rok, muzikë festive etj.), përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, IV-1, V-9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 4.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Muzika zbavitëse (e lehtë)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon muzikën zbavitëse kur e dëgjon;
- Njeh disa nga festivalet tona.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, Fletorja e punës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja e lëshon këngën “Pranvera në Prishtinë”, e cila është këngë fituese në festivalin “Akordet e Kosovës”. Pasi ta kenë dëgjuar, nxënësit pyeten:

- Çfarë mund të thoni për tekstin dhe muzikën e saj?

Muzika zbavitëse (e lehtë)



Dëgjoni këngën “Pranvera në Prishtinë”, e cila është edhe këngë fituese në festivalin “Akordet e Kosovës”. Çfarë mund të thoni për tekstin dhe muzikën e saj?

Muzika zbavitëse, e njohur edhe si muzika e lehtë, shërben, para së gjithash, për argëtim dhe vallëzim. Ajo interpretohet edhe nga profesionistët, edhe nga amatorët.

**Kënga e muzikës zbavitëse**

Kënga është një kompozim i përbërë nga teksti poetik dhe muzika. Për bashkimin e tekstit me muzikën kujtoni kantatën, oratorion, muzikën skenike (operën e operetën) e të tjera, me të cilat jemi njohur në klasat e mëparshme dhe në këtë libër. Gjithsesi, modeli i këngës që njohim edhe sot, filloi të përhapet në shekullin XIX.



Disa nga karakteristikat kryesore të saj janë:

- ▶ Ka një melodi të thjeshtë, shpesh të ndërtuar mbi ritme të njohura.
- ▶ Ka një strukturë në të cilën alternohen strofat dhe refreni.
- ▶ Mund të shoqërohet edhe nga një instrument i vetëm (për shembull, pianoja ose kitara).
- ▶ Ka një tekst që dëgjohet lehtësisht, i cili është frymëzuar nga ndjesi, emocione apo përjetime personale që lidhen me çështje të caktuara sociale.

**“Akordet e Kosovës”**

“Akordet e Kosovës” ka qenë ndër festivalet e para (1963) që kultivoi muzikën zbavitëse. Ky festival kishte shikueshmëri dhe popullaritet të madh. Ai mbulonte gjeografikisht një hapësirë të madhe, nga Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Kroacia e deri në Slloveni, dhe kishte edhe audiencë ndërkombëtare.

Festivali u krijua në Prishtinë e viteve gjashtëdhjetë nga një grup muzikantësh me shkolim akademik, të tubuar në "Radio Prishtinë" e dikurshme.

Në festivalin që zgjaste tri ditë, këndohej në tri-katër gjubë, por mbizotëronte muzika shqipe.

Në ditën e parë të festivalit paraqiteshin krijimet e muzikës për fëmijë, në ditën e dytë paraqiteshin krijimet e frymëzuara nga melosi popullor, ndërsa dita e tretë i kushtohej muzikës së lehtë.

Çdo mbrëmje, ndahej shpërblimi më i lartë "Okarina e Artë", si edhe një sërë shpërblimesh të tjera.

Ndër kompozitorët që kanë marrë vazhdimisht pjesë në këtë festival, janë: Musa Piperku, Pranvera Badivuku, Reshat Randobrava, Tomor Berisha, Jusuf Gërvalla etj.



► Pranvera Badivuku, kompozitore

### "Festivali i Këngës" në Radio Televizionin Shqiptar

Në vitin 1962, nisi udhën një traditë e këngës së lehtë shqipe. Në këtë festival që zhvillohet gjatë disa netëve, marrin pjesë këngëtarë të rinj dhe këngëtarë të afirmuar. Deri në vitet '90, këngët pjesëmarrëse në këtë festival i nënshtroheshin censurës së kohës.

Pas këtyre viteve, në këtë festival do të paraqiteshin këngë të larmishme dhe do të merrnin pjesë edhe krijues e këngëtarë nga të gjitha viset shqiptare.

Prej vitit 2003, fituesi ose fituesja e Festivalit të Këngës në RTSH ka përfaqësuar Shqipërinë në Eurovizion. Këngëtarja që ka fituar më shumë çmime të para në historinë e këtij festivali, është Vace Zela. Disa prej këngëtarëve fitues që kanë interpretuar në Eurosong, janë: Aurela Gace, Rona Nishliu, Anjeza Shahini, Eugent Bushpepa etj.



► Albina dhe familja Kelmendi, pjesëmarrës në Eurovizion 2023, me këngën "Duje".

#### Detyrë

► Përzgjidhni një nga këngët e muzikës zbatimëse që ju pëlqen më shumë. Vlerësoni, nëpërmjet një shkrimi të shkurtër, veçoritë e muzikës dhe të tekstit të saj.

77



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Nxënësit të ndarë në tre rreshta udhëzohen që të lexojnë pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja në mënyrë të pavarur. Disa nxënës do të shpjegojnë pjesën e caktuar, duke u bazuar në këto pyetje.

#### Rreshti I: Kënga e muzikës zbatimëse

Çfarë është kënga? Kur filloi të përhapej muzika zbatimëse? Cilat janë disa nga karakteristikat e muzikës zbatimëse?

#### Rreshti II: Akordet e Kosovës

Cilën muzikë e kultivoi festivali "Akordet e Kosovës"? Nga cilat shtete kishte shikueshmëri ky festival? Sa ditë zgjaste festivali dhe cilat ishin krijimet që paraqiteshin gjatë atyre ditëve? Çfarë është "Okarina e Artë"? Cilët janë kompozitorët që kanë marrë vazhdimisht pjesë në këtë festival?

#### Rreshti III: Festivali i Këngës në Radio Televizionin Shqiptar

Në cilin vit u mbajt për herë të parë "Festivali i Këngës" në "Radio Televizionin Shqiptar"? Pas vitit 2003, çfarë

ndodhte me fituesin apo fituesen e këtij festivali? Kush ka fituar më së shumti çmime në historinë e këtij festivali? Cilët janë disa nga këngëtarët fitues që kanë interpretuar në "Eurosong".



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit, të udhëzuar nga mësimdhënësi, do të plotësojnë në mënyrë të pavarur faqen 48 në fletoren e punës.

#### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 25-26.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Këngë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Eja në Prishtinë

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Respekton rregullat e këndimit të drejtë;
  - Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.



**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja shkruan në qendër të tabelës fjalën “Prishtina” dhe kërkon nga nxënësit që të shënojnë të dhëna lidhur me të.





### "Eja në Prishtinë"

Muzika: Musa Piperku

*Intro Canto*



*Canto 2*



*Ref.*



- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?

79



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;
Leximi dhe analiza e vargjeve;
Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësve;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Udhëzohen nxënësit që këngën ta këndojnë drejt (saktë), me frymëmarrje të duhur dhe artikullim të qartë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 49-50.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Zhanret muzikore

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Dallojnë dhe krahasojnë veprat sipas zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, xhaz, rok, muzikë festive etj.), përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:** I-1, IV-1, V-9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.2; 1.3; 3.1; 4.3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Muzika xhaz

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Dallon muzikën xhaz përmes dëgjimit;
- Njeh disa nga interpretuesit më të dalluar të muzikës xhaz.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja e lëshon për ta dëgjuar këngën “It don’t mean a thing”, e Djuk Ellingtonit (Duke Ellington). Më pas, pyeten nxënësit:

- Çfarë ju bëri përshtypje?

## Muzika xhaz



**Dëgjojmë**

Dëgjeni këngën “It don’t mean a thing” (“Nuk do të thotë asgjë”), të Djuk Ellingtonit. Çfarë ju bëri përshtypje?



**Çelësat e mëimit**

zhanër muzikor orkeshtër xhaz  
 Improvizim muzikë xhaz

### Kur dhe si lindi muzika xhaz?

Muzika xhaz (*jazz*) është një zhanër muzikor që për herë të parë u shfaq në Shtetet e Bashkuara të Amerikës mes fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX.

Kjo muzikë është rezultat i shkrirjes së muzikës së skllavërve të sjellë nga Afrika dhe kulturës së kolonizatorëve (sidomos anglezë). Në orët e gjata të punës, kur burra dhe gra ishin të detyruar të punonin për orë të tëra të lodhshme, këngët e punës (*work songs*) që i këndonin të gjithë së bashku, u kujtonin ritmet e tokës së largët afrikane.



► Skllavërit afrikane janë transportuar me forcë

Këngët ishin pothuajse gjithnjë të improvizuara në cast. Zakonisht një skllav këndonte një fjali muzikore, së cilës të tjerët i përgjigjeshin me fjali të tjera muzikore.



► Rej Carls (Ray Charles)

### Qyteti i xhazit

Pas shfuqizimit të skllavërisë, të zinjët emigruan drejt qyteteve në jug dhe në veri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky emigrim çoi në një rritje të ndjeshme të popullsisë, rritje që ndikoi dalëngadalë në traditat dhe kulturën e këtyre qyteteve.

Mes qyteteve që në këtë proces ka pasur një rol të rëndësishëm, është Nju-Orlinsi, megjithëse xhazi u përhap edhe në qytete të tjera.

Pikërisht në këtë qytet janë shfaqur interpretuesit e mëdhenj të muzikës xhaz: Xho King Oliver, Luis Armstrong, Sidnej Beket e shumë të tjerë.

Mënyra e interpretimit të këtij zhanri muzikor është shumë individuale për shkak të improvizimit që është karakteristikë e xhazit. Kjo mënyrë interpretimi kërkon angazhim dhe kreativitet maksimal nga ana e interpretuesit.



► Luis Armstrong

### Orkestra xhaz (jazz band)

Orkestrat e para xhaz, të njohura si *jazz band*, përbëheshin nga një sërë instrumentesh frymore, si tromba, tromboni, saksofoni e klarineta dhe nga pianoja, bateria, kitara etj.

Në këto orkestra të improvizuara nuk kishte barriera sociale dhe pasioni për muzikën mbllidhte së bashku të varfrit e bardhë e të zinj.

Ndër përfaqësuesit më të njohur të muzikës xhaz, përmendim: Luis Armstrong (këngëtar e trombitist), Djuk Ellington (pianist, kompozitor), Rej Çarls (pianist, këngëtar, kompozitor), Glen Miler (klarinetist, kompozitor), Ela Fixheralld (këngëtare) etj.



#### Në dhe interneti

Kërkoni në internet "Sonatën për saks, alto dhe piano" të Fil Vudsit (Phil Woods), një shembull interesant i ndërthurjes së muzikës xhaz me muzikën klasike.



#### Detyrë

Dëgjoni këngën "I Can't Give You Anything but Love", të interpretuar nga Luis Armstrong.

Çfarë vëreni? Interpretuesi i këngës:

- |  |   |
|--|---|
| <input type="checkbox"/> vetëm këndon,                         | <input type="checkbox"/> vetëm luan në instrument,                |
| <input type="checkbox"/> edhe këndon, edhe luan në instrument, | <input type="checkbox"/> shoqërohet vetëm nga pianoja,            |
| <input type="checkbox"/> shoqërohet nga një orkestër,          | <input type="checkbox"/> nuk shoqërohet nga instrumente të tjera. |

81



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Nxënësit, të ndarë në tre rreshta, udhëzohen që të lexojnë pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja në mënyrë të pavarur. Disa nxënës do të shpjegojnë pjesën e caktuar duke u bazuar në këto pyetje.

### Rreshti I: Kur dhe si lindi muzika xhaz?

Ku dhe kur lindi muzika xhaz? Nga kush është krijuar kjo muzikë? Në çfarë situata këndohej ky lloj i muzikës?

### Rreshti II: Qyteti i xhazit

Si u përhap xhazi në Nju Orlins dhe në qytete të tjera? Cilët janë interpretuesit më të mëdhenj të muzikës xhaz? Si është mënyra e interpretimit të këtij zhanri muzikor?

### Rreshti III: Orkestra xhaz

Nga cilat instrumente përbëhej orkestra xhaz? Cilët ishin përfaqësuesit më të njohur të muzikës xhaz?



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit, në mënyrë të pavarur, e plotësojnë detyrën në faqen 81 të librit bazë, pas dëgjimit të këngës së përzgjedhur në libër.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 51-52.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.*

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Zhanret muzikore

### Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallojnë dhe krahasojnë veprat sipas zhanreve muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, xhaz, rok, muzikë festive etj.) përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, IV-1, V-9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.2; 1.3; 3.1; 4.3.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Muzika rok

### Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon muzikën rok përmes dëgjimit.
- Njeh disa nga interpretuesit më të dalluar të muzikës rok.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, Fletorja e punës.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**

Mësimdhënësi/ja e lëshon këngën "Era", nga grupi Gjurmët. Pasi ta kenë dëgjuar, nxënësit pyeten:

- Çfarë ju bëri përshtypje?



**Dëgjojmë**

Dëgjoni këngën "Era", të interpretuar nga grupi Gjurmët. Çfarë ju bën përshtypje?

### Veçoritë

Muzika rok lindi në vitet '50, pas Luftës së Dytë Botërore, në një kontekst ndryshimesh të mëdha sociale në botën perëndimore.



► Grupi muzikor "Rolling Stones"

Ata që krijojnë e luajnë muzikë rok, dëshirojnë të ndajnë emocionet e tyre me një numër sa më të madh njerëzish. Për këtë arsye, gjuha e rokut është shumë e thjeshtë në aspektin muzikor. Ajo përbëhet nga pak akorde dhe nga ritmet thelbësore që gjithsesi janë të mjaftueshme për t'i përcjellë emocionet dhe përvojat e jetuara nga njerëz të etnive, feve, moshave dhe bindjeve të ndryshme.

Sa u përket teksteve të këngëve rok, ato trajtojnë probleme sociale, denoncojnë padrejtësitë dhe luftojnë për të drejtat e njeriut.

Në muzikën rok janë të zakonshme grupet e përbëra nga tri deri në pesë elemente. Një grup tipik roku përbëhet nga kitara elektrike, kitara bas elektrike, bateria dhe solisti. Herë pas here janë të pranishme edhe tastierat dhe sintetizatori.

Në muzikën rok, solisti zë vend qendror me zërin e tij, por edhe kitara ka një rol të spikatur.



► Grupi muzikor "The Runaways"

## Melodia dhe ritmi

Muzika rok luhet më së shumti në kohën 4/4 (ose në kohë të ngjashme).

Zhvillohet në formën e këngës, përmes alternimit strofë-refren, megjithëse njësia më e vogël që e përbën atë është rifi.

Disa nga përfaqësuesit më të njohur, janë: "Beatles", "Rolling Stones", Bob Dilan, Xhimi Hendriks, "Pink Floyd", "The Runaways" etj.



► Grupi muzikor "Beatles" (lexo: Bitëll)

Rif (Riff) - pjesa më e vogël përbërëse e muzikës rok. Është një vijimësi e shkurtër notash që përsëritet shpesh gjatë pjesës dhe shërben si "tullë" për ndërtimin e strofës.



► Grupi muzikor "Minatori"

Merita e madhe e gjeneratës së parë të muzikës rok është se ajo ka thyer tabutë e shoqërisë sonë në një kontekst delikat politik, duke treguar shtysën për të përqafular vlerat e botës perëndimore.



► Grupi muzikor "Fisnikët"



### Detyrë

► Dëgjoni këngën "With or Without you" ("Me ose pa ty") të grupit irlandez "U2". Renditni veçoritë e muzikës rok që arrini të dalloni te kjo këngë.

83



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Nxënësit, të ndarë në tre rreshta, udhëzohen që të lexojnë pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja në mënyrë të pavarur. Disa nxënës do të shpjegojnë pjesën e caktuar, duke u bazuar në këto pyetje.

### Rreshti I: Veçoritë

Kur lindi muzika rok? Çfarë problemesh trajtojnë tekstet e këngëve rok? Nga cilat instrumente përbëhet një grup rok?

### Rreshti II: Melodia dhe ritmi

Në cilën kohë luhet muzika rok? Cilët janë disa nga përfaqësuesit më të njohur të rokut?

### Rreshti III: Roku flet shqip

Kur u krijua grupi i parë shqiptar i rokut? Cilat janë grupet e rokut më të njohura shqiptare? Çka u konsiderua meritë e gjeneratës së parë të muzikës rok?



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit, në mënyrë të pavarur, e plotësojnë detyrën në faqen 53, në fletoren e punës.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 53-54.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Këngë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, individualisht ose në grup, këngë dhe melodi nga zhanre të ndryshme (artistike, popullore, muzikë e lehtë), sipas tekstit notal dhe imitimit.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, 6; III-6, 7; V-6, VI-6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Blowing in the Wind

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Respekton rregullat e këndimit të drejtë;
- Këndon me emocion.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, pianoja/sintisajzeri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënësit**

Mësimdhënësi/ja e lëshon këngën “Blowing in the Wind”, e kantautorit Bob Dylan dhe kërkon nga nxënësit që të përshkruajnë gjatë kohës së dëgjimit të saj.

“Blowing in the Wind”



Dëgjoni këngën “Blowing in the Wind” të kantautorit amerikan Bob Dylan. Përshkruani emocionet tuaja gjatë dëgjimit të saj.

Bob Dilani ishte këngëtar, tekstshkrues, muzikant, piktor e poet i njohur në botë. Ai vlerësohet si njeriu që ka ndikuar në muzikën popullore dhe kulturën botërore në më shumë se pesë dekada. Bob Dilani është edhe fitues i çmimit Nobel në letërsi, me motivacionin: “Për krijimin e shprehjeve të reja poetike në traditën e madhe të këngës amerikane”.

Kënga “Blowing in the Wind” u bë himn kundër luftës dhe i lëvizjeve për të drejtat civile.

“Blowing in the Wind”

<i>Show many roads must a man walk down Before you call him a man? How many seas must a white dove sail Before she sleeps in the sand? Yes, and how many times must the cannonballs fly Before they're forever banned?  The answer, my friend, is blowin' in the wind The answer is blowin' in the wind</i>	<i>The answer, my friend, is blowin' in the wind The answer is blowin' in the wind  Yes, and how many times must a man look up Before he can see the sky? And how many cars must one man have Before he can hear people cry? Yes, and how many deaths will it take 'til he knows That too many people have died?  The answer, my friend, is blowin' in the wind The answer is blowin' in the wind.</i>
---	--

### "Blowing in the Wind"

Teksti dhe muzika: Bob Dylan

How ma - ny roads must a man walk down be -  
fore you can call him a man? Yes and  
how ma - ny seas must a white do - ve sail be -  
fore she sleeps in the sand? Yes, and  
how ma - ny times must the can - non balls... fly be -  
fore they 're for - ev - er banned? 'The  
an - swer, my friend, is blow - ing in the wind, the  
an - swer, is blow - ing in the wind.

- ▶ Si e kuptoni tekstin e kësaj kënge? Shprehni mendimet tuaja.
- ▶ Çfarë shpreh kjo këngë nëpërmjet melodisë së saj?

85



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e realizojnë procedurën e përpunimit të këngës, sipas veshit, në këto etapa:

Prezantimi i përmbajtjes dhe titulli;
Leximi dhe analiza e vargjeve;
Demonstrimi i këngës në fraza, me këndim alternativ në mes mësimdhënësit dhe nxënësve;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës;
Demonstrimi i tërësishëm i këngës nga mësimdhënësi, me elementet e saj: ngjyrimi dinamik dhe shoqërimi instrumental.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit udhëzohen që këngën ta këndojnë drejt (saktë), me frymëmarrje të duhur dhe artikullim të qartë.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

Të plotësojë fletoren e punës, në faqet 55-56.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

---

---

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Kreativitet muzikor

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shfrytëzon teknologjinë bashkëkohore (dhe atë muzikore), sipas interesimit dhe prirjes për të krijuar shprehje origjinale muzikore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, IV-1, V-9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 1.7; 2.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Videoklipi muzikor

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Debaton për videoklipe të ndryshme muzikore;
- Analizon ndërlidhjen e videoklipit muzikor me përmbajtjen.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja, projektori.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Jeta dhe puna.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja e lëshon videoklipin e këngës “Shine ya Light” të Rita Orës dhe, më pas, i pyet nxënësit:

- Çfarë mund të thoni për realizimin e tij?

## Videoklipi muzikor



**Dëgjojmë**

Shikoni videoklipin muzikor të realizuar nga Rita Ora për këngën “Shine Ya Light”. Çfarë mund të thoni për realizimin e tij?

Videoklipi është një film i shkurtër që ilustron një këngë, një poezi, një mesazh politik ose një tekst të caktuar. Ai synon të krijojë një spektakel pamor, sipas një ideje narrative. Në vijim do të njihemi me videoklipin muzikor.

### Çfarë është videoklipi muzikor?

Zhvillimet në teknologji, përfshirë përdorimin e sintetizatorit si një mjet që krijon muzikë dhe jo si një zëvendësues të instrumenteve muzikore, përbëjnë një revolucion të vërtetë. Ekzekutimi instrumental u mënjana dhe ua la skenën këngëtarëve që kërcenin dhe ndërvepronin me publikun, duke krijuar hapësirën e duhur për lindjen dhe përsosjen e videoklipeve muzikore.



Videoklipi muzikor është një filmim i shkurtër, zakonisht i frymëzuar nga teksti ose muzika, me një skenar e fabul që e fuqizon këngën për të cilën krijohet.

### Roli i videoklipeve muzikore



Një rol qendror në afirmimin e yjeve të muzikës së viteve tetëdhjetë luajtën kanalet televizive muzikore, në krye të të cilave qëndronte MTV (akronim për *Music Television*). Në këtë kanal videoklipet transmetoheshin njëri pas tjetrit, duke shkaktuar një dukuri që ndodhi në masë mes të rinjve: i kalonin ditët e gjata duke parë në ekran të pëlgjerit e tyre. Në këtë mënyrë, numri i shfaqjes së videoklipeve u



bë përgjegjës i drejtpërdrejtë i famës dhe i shitjes së albumeve të këngëtarëve.

Nga performanca të thjeshta të regjistruara zakonisht në një studio, videoklipet u bënë brenda një kohe fare të shkurtër, në formë filmash të shkurtër, me buxhet shumë të lartë, që drejtoheshin nga regjisorë të nivelit të lartë.

Suksesi i disa artistëve është ngushtësisht i lidhur me videoklipet e tyre. Për shembull, grupi norvegjez "A-ha" u bë shumë i njohur me *Take on me*, një video që pasi pushtoi të gjithë transmetuesit televizivë për vite të tëra me radhë, vazhdon të ketë suksese në *YouTube*, me më shumë se një miliard klikime. Edhe vetë Madona, ia detyron popullaritetin në fillimet e saj mënyrës së shfaqjes në videoklipe, si: *Holiday*, *Everybody* dhe *Virgin*.



### Videoklipe të njohura

Në hapësirën mbarëshqiptare, shumë artistë të mirënjohur kanë realizuar videoklipe mbresëlënëse.

Po ashtu, disa artistë shqiptarë njihen ndërkombëtarisht si për aftësitë vokale, ashtu edhe për videoklipet e realizuara, siç janë: Rita Ora, Dua Lipa, Bebe Rexha, Era Istrefi etj.



Ndër videoklipet më të njohura muzikore në botë, përmendim: *Thriller* të këngëtarit Majkell Xhekson, *Karma Police* të grupit "Radiohead", *Smells Like Teen Spirit* të grupit "Nirvana" etj.



#### Detyrë

➤ Perzgjidhni një nga videoklipet që ju pëlqen më shumë. Vlerësoni, nëpërmjet një shkrimi të shkurtër, veçoritë e realizimit të tij.

87



### Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi ndahet në tre paragrafë. Udhëzohen nxënësit që të lexojnë paragrafin e parë "Çfarë është videoklipi muzikor?" në mënyrë individuale dhe, më pas, një nxënës ta komentojë atë. Pasi të komentohet paragrafi i parë, lexohen edhe paragrafët e tjerë, "Roli i videoklipeve muzikore" dhe "Videoklipe të njohura". Komentohet pas çdo paragrafi të lexuar.



### Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit e plotësojnë ushtrimin I në faqen 57 të fletores së punës.

### Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### Detyrë:

T'i plotësojë ushtrimet II dhe III në faqen 57, në fletoren e punës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Kreativitet muzikor

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Krijon tërësi të reja muzikore në bazë të ritmit, tekstit poetik etj.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, IV-1, V-9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.7; 2.1; 3.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Krijojmë një këngë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**

- Njeh rregullat e krijimit muzikor.
- Krijon melodi të thjeshta në mënyrë të pavarur.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, pentagrami.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja e lëshon për ta dëgjuar këngën “Unë biri yt, Kosovë”, interpretuar nga Inva Mula, dhe, më pas, i pyet nxënësit:

- Çfarë emocionesh përcolli ky interpretim?
- Përse mendoni që ky interpretim ishte i veçantë?

Përmes këtyre dy pyetjeve, arrihet deri te njësia mësimore që do të zhvillohet.

## Krijojmë një këngë

Për të shkruar një këngë mund të ndiqen dy rrugë:

- Duke shkruar muzikën, së cilës më pas do t'i përshtatni tekstin e duhur.
- Duke shkruar ose duke gjetur një poezi të bukur, për të cilën do të krijoni një muzikë të përshtatshme.



**1** Në vijim do të gjeni një melodi këngë. Shkruani poshtë notave të saj një tekst të përshtatshëm. Në fund, provoni ta këndon këngën tuaj.

2 Krijoni ose shkruani vargjet e një poezie që ju pëlqen. Tani, përpiqini të shkruani muzikën që i përshkruan më mirë asaj.



### **Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes**

Nxënësit ndahen në 5 grupe. Pasi mësimdhënësi/ ja u sqaron nxënësve dy rregullat e krijimit të një kënge, kërkon nga nxënësit që melodisë në faqen 88, t'ia shkruajnë një tekst në grup. Më pas, secili grup e provon këngën e krijuar.



### **Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit**

Nxënësit të ndarë në grupe do të kryejnë detyrën 2 në faqen 89 të librit bazë. Në fund, do të përzgjidhet kënga më e mirë e krijuar.

### **Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësim i vazhdueshëm.

#### **Detyrë:**

Të plotësojë fletoren e punës, në faqen 58.



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Artet  
**Lënda:** Edukatë muzikore  
**Shkalla e kurrikulës:** IV **Klasa:** VIII  
**Tema:** Kreativitet muzikor

**Rezultatet e të nxënit të temës:**  
 Shfrytëzon teknologjinë bashkëkohore (dhe atë muzikore), sipas interesimit dhe prirjes për të krijuar shprehje origjinale muzikore.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I-1, IV-1, V-9.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.3; 1.7.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Muzika e filmit

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon muzikën e filmave përmes dëgjimit;
  - Njeh disa nga kolonat zanore përmes dëgjimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libri bazë, CD-ja etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Shkencat e natyrës.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Parashikimi:**  
**Përgatitja për të nxënë**

Mësimdhënësi/ja e lëshon këngën “My heart will go on”, interpretuar nga Selin Dion për filmin “Titanik”. Pasi ta kenë dëgjuar, nxënësit pyeten:

- A mund t'i përshkruani emocionet që ju përcolli?

Muzika e filmit



Dëgjoni këngën “My heart will go on”, të interpretuar nga Selin Dion për filmin “Titaniku”. Përshkruani emocionet që ju përcolli ajo.



**Rëndësia e kolonës zanore**

Me zhvillimin ndër vite të kinematografisë, muzika është lidhur ngushtësisht me filmin.

Kolona zanore e një filmi është shumë e rëndësishme për suksesin e tij. Këtë e dëshmon edhe fakti se jepet çmimi “Oscar” për kolonat më të mira zanore.

Janë të shumtë muzikantët që i përkushtohen vetëm këtij zhanri. Njëpërjet gjuhës muzikore, ata synojnë të shprehin sa më shumë mbi pamjet e filmit.

Disa nga kompozitorët më të njohur që kanë shkruar muzikë filmi, janë Xhon Uilliams (filmat “Indiana Jones”, “Star Wars”), Enio Morikone (filmat “Mission”, “Na ishte njëherë në Amerikë”), Xhorxh Gershuin etj.

Kënga që shoqëron skenat kulmore në film, ndonjëherë njihet si sukses ndërkombëtar dhe hyn në klasifikimet e shitjeve muzikore. Një shembull i kësaj dukurie është kënga “My heart will go on”, e interpretuar nga Selin Dion për filmin “Titaniku”.



## Muzika e filmave tanë

Kinematografia në Kosovë ka një histori prej disa dekadash. Në vitet 1935-37, u hapën shtatë kinematë e para, në qytetet: Mitrovicë, Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, Prizren, Gjakovë dhe Pejë.

Filmi i parë në Kosovë është "Uka i Beshkëve të Nemuna" (1968), me muzikë të Rexho Mulliqit, kurse filmi i parë në Shqipëri, është "Tana" (1958), me muzikë të Çesk Zadesë.

Vetëm një vit pas realizimit të filmit të parë (1969), do të themelohej "Kosovafilm", organizata e prodhimit dhe shpërndarjes së filmit.

Ndër kompozitorët që i janë përkushtuar muzikës së filmit, përmendim: Rauf Dhomi (filmi "Kur pranvera vonohet"), Bozidar Kramariçi (filmi "Gjurmë të bardha"), Bashkim Shehu (filmi "Lepuri me pesë këmbë"), Rexho Mulliqi (filmi "Era dhe lisi"), Feim Ibrahim (filmat "Ngadhënim mbi vdekjen", "Prilli i thyer", "Balada e Kurbinit" etj.), Tish Daija (filmat "Tinguj lufte", "Fëmijët e saj" etj.), Kujtim Laro ("Nëntori i dytë", "Udha e shkronjavë", "Lulekuqet mbi mure" etj.), Aleksandër Lalo (filmat "Tomka dhe shokët e tij", "Treni nisat në shtatë pa pesë", "Dy herë mat" etj.).



### Detyrë

► Përzgjidhni një nga filmat që ju pëlqen më shumë. Vlerësoni, nëpërmjet një shkrimi të shkurtër, veçoritë e muzikës së tij.

91



## Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi ndahet në dy paragrafë. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që të lexojnë paragrafin e parë "Rëndësia e kolonës zanore" në mënyrë individuale dhe, më pas, një nxënës ta komentojë atë. Pasi të komentohet paragrafi i parë, lexohet edhe paragrafi tjetër "Muzika e filmave tanë" i cili komentohet po ashtu.



## Përforcimi: Konsolidimi i të nxënit

Nxënësit i plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës, në faqen 59.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësim i vazhdueshëm.

### Detyrë:

T'i plotësojë detyrat në librin bazë, në faqen 91.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*